



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.548/ 7 prot.

Datë 12.03.2026

V E N D I M
Nr. 386/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 12.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76063-02-12-2026, me objekt: *Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”* me fond limit 11,251,992.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara
- Ankimues:** Operatori ekonomik “NRG” SHPK me NIPT L13426006B dhe adresë: *Farkë, Rruga “Eduart Mano”, Pallatet Nr.10, Kopshti Zologjik, Selitë, Tiranë*
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara me adresë: *Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i

ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76063-02-12-2026, me objekt:

Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës” me fond limit 11,251,992.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara

II.2. Në datën 20.02.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me numër A/2026/6353 datë 20.02.2026 dhe nr.548/2026 prot., datë 23.02.2026, i operatorit ekonomik “NRG” SHPK duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me datë 26.02.2026 operatori ekonomik “NRG” SHPK ka ngarkuar në Sistemin e Ankesave Elektronike formularin e paraqitjes së argumentave i cili u protokollua me tonën me nr. 548/1 prot., datë 26.02.2026 duke pretenduar:

Lidhur me ankimin e paraqitur nga “NRG” shpk
(Ankesë nr A/2026/6351, A/2026/6362, A/2026/6353, A/2026/6354, A/2026/6355)

Të Nderuar

Siç dihet Operatori i Blerjeve të Përqendruar ka publikuar dokumentet e tenderit për procedurën me objekt “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, ndarë në 5 lote (Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë), lidhur me të cilat kemi paraqitur ankim me datë 20.02.2026 duke arsyetuar e detajuar shkaqet.

Në vijim të këtij ankimi, çmojmë të domosdoshme të evidentojmë në mënyrë më të hollësishme një sërë argumentash lidhur me shkaqet e parashtruara në ankim që tregojnë mospërputhshmëritë e forta të DST, të cilat jo vetëm që nuk garantojnë zhvillim të procesit të prokurimit sipas kërkesave ligjore, por në fakt venë haptazi në dyshim integritetin e këtij procesi.

I. Në lidhje me kriterin ekonomik:

Në Dokumentet Standarde të Tenderit janë përcaktuar në mënyrë të detajuar kriteret kualifikuese për çdo lot. Veçanërisht, në Lotin 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”, në pikën 2 “Kriteret e veçanta të prokurimit”, nën pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar, është parashikuar si më poshtë:

“2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën një (1) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.”

Në këtë pikë është përcaktuar vetëm xhironja vjetore si kriter i vetëm kualifikues, për sa i përket vërtetimit nga operatori ekonomik të kapacitetit ekonomik dhe financiar me qëllim përmbushjen e objektit të kontratës.

Ndërsa, në lotet e tjera të së njëjtës procedurë, konkretisht:

- **Loti 2:** “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”
- **Loti 3:** “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”
- **Loti 4:** “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”

- **Loti 5:** “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”

për sa i përket kriterit ekonomik dhe financiar, është përcaktuar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.*

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Standardet e dyfishta të aplikuara në DST ndërmjet Lotit 1 dhe loteve të tjera nuk janë thjesht dallime teknike, por devijime substanciale dhe ky diferencim përbën një nga problematikat e DST.

Për Lotin 1 – “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”:

- Kërkohet xhiro minimale vetëm 40% e fondit limit, e realizuar në të paktën një nga vitet 2022–2024;
- Nuk kërkohet paraqitja e bilanceve vjetore të shoqëruara me akt-ekspertizë kontabël;
- Nuk kërkohet verifikimi i raportit aktiv/pasiv;
- Kërkohet eksperiencë e mëparshme në masën 20% të fondit limit.

Për Lotet 2, 3, 4 dhe 5 – (Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë):

- Kërkohet xhiro minimale në masën 100% të fondit limit, e realizuar në të paktën një nga vitet 2022–2024;
- Kërkohet paraqitja e bilanceve trevjeçare të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar;
- Kërkohet që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos ketë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit;
- Kërkohet eksperiencë e mëparshme në masën 40% të fondit limit.

Diferencimi i theksuar i kritereve ekonomike dhe financiare ndërmjet Lotit 1 dhe loteve 2, 3, 4 dhe 5, pavarësisht se të gjitha kanë si objekt të njëjtin shërbim, dezinfektimin e zonave urbane dhe bregdetare, përbën një devijim të pajustificuar nga parimet themelore të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në veçanti nga parimi i proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe garantimit të konkurrencës efektive. Kërkesa që për Lotin 1 të mjaftojë një xhiro minimale në masën 40% të fondit limit dhe një eksperiencë në masën 20%, ndërkohë që për lotet e tjera kërkohet xhiro në masën 100% të fondit limit, eksperiencë 40%, si dhe dokumentacion financiar shumë më i detajuar, përfshirë bilance të certifikuara nga ekspert kontabël dhe analiza të raportit aktiv/pasiv, nuk reflekton një dallim objektiv në natyrën apo kompleksitetin e shërbimit, por krijon standarde të ndryshme kualifikimi për të njëjtin lloj kontrate. Në kushtet kur shërbimi i dezinfektimit realizohet mbi të njëjtat metoda teknike, me të njëjtat pajisje dhe produkte biocide dhe mbi bazën e të njëjtave kërkesa ligjore dhe sanitare, vendosja e pragjeve të ndryshme financiare nuk rezulton e mbështetur në ndonjë analizë të dokumentuar të riskut, kompleksitetit apo volumit teknik që do të justifikonte një trajtim të diferencuar.

Ky diferencim merr rëndësi edhe më të madhe për faktin se është vendosur nga i njëjti autoritet kontraktor, brenda së njëjtës procedurë prokurimi dhe në të njëjtën kohë, çka përjashton çdo mundësi justifikimi mbi bazën e ndryshimit të praktikave institucionale apo evoluimit të standardeve në kohë. Në këto kushte, aplikimi i pragjeve të ndryshme financiare dhe ekonomike krijon një trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë në varësi të lotit për të cilin ata konkurrojnë dhe cenon parimin e neutralitetit të procedurës. Në aspekt praktik, kjo situatë krijon një paradoks procedural, pasi një operator ekonomik që konsiderohet i kualifikuar për të realizuar shërbimin në Lotin 1, sipas standardit të vendosur nga vetë autoriteti kontraktor, mund të konsiderohet automatikisht i pakualifikuar për lote të tjera që kanë të njëjtën natyrë shërbimi, vetëm për shkak të vendosjes artificiale të pragjeve më të larta financiare, pa një justifikim objektiv teknik apo operacional.

Për më tepër, vendosja e kërkesave shtesë vetëm për disa lote, si paraqitja e bilanceve të certifikuara dhe verifikimi i raportit aktiv/pasiv, përbën një shtim selektiv të filtrave financiarë që nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë reale për të realizuar shërbimin, por krijon një pengesë administrative dhe financiare që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në mënyrë të pabarabartë. Në mungesë të një arsytimi teknik dhe ekonomik të dokumentuar që të provojë se realizimi i shërbimit në këto lote kërkon një nivel ndjeshëm më të lartë stabiliteti financiar se ai i kërkuar për Lotin 1, ky diferencim përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës

dhe bie ndesh me nenin 77 të ligjit nr. 162/2020, i cili kërkon që kriteret të jenë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Në këto rrethana, diferencimi ekstrem i pragjeve të kualifikimit, nga 40% në 100% për xhiron minimale dhe nga 20% në 40% për eksperiencën e mëparshme, i kombinuar me vendosjen selektive të kërkesave shtesë financiare vetëm për disa lote, krijon një dyshim të arsyeshëm mbi objektivitetin e hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe cenon besimin legjitim të operatorëve ekonomikë në ekzistencën e një gare reale, të hapur dhe të paanshme. Një strukturë e tillë kriteresh, në mungesë të një justifikimi të qartë teknik dhe ekonomik, krijon premisa për deformimin e konkurrencës dhe bie në kundërshtim me qëllimin e legjislacionit të prokurimit publik për të garantuar përdorimin efikas të fondeve publike dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të kualifikuar.

Në këto lote, konstatohet se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se kushti për përmbushjen e kriterit ekonomik dhe financiar nuk është vetëm xhiroja e tre viteve të fundit, por ka vendosur edhe kriterin shtesë të paraqitjes së bilanceve vjetore për tre vitet e fundit, të shoqëruara me akt ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Sa më sipër, mbështetur në bazën ligjore si më poshtë, parashtrojmë:

Në nenin 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:
“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Vendosja selektive e kriterëve për lote të ndryshme të së njëjtës procedurë bie ndesh me këto qëllime të parashikuara shprehimisht në ligj.

Në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:
“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë dhe në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.”

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Mungesa e kriterit për Lotin 1 favorizon operatorë që nuk përmbushin standardin ekonomik-financiar të kërkuar për lotet e tjera, duke cenuar në këtë mënyrë parimet themelore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Në nenin 21 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:
“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike dhe nevojat e tij, si dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Mungesa e arsytimit objektiv për diferencimin e Lotit 1 përbën shkelje të këtij detyrimi ligjor.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Objekti i të gjitha loteve është homogjen në natyrë: “Shërbim dezinspektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, i ndarë sipas qarqeve administrative. Nuk kemi të bëjmë me shërbime të një natyre të ndryshme, me profile teknike apo risk operacional të ndryshëm, por me të njëjtin lloj shërbimi, të zbatuar në territore të ndryshme. Diferenca qëndron vetëm në shtrirjen gjeografike dhe në vlerën e fondit limit, jo në kompleksitetin teknik të shërbimit. Për pasojë, çdo dallim në metodologjinë e verifikimit të kapacitetit ekonomik duhet të jetë i arsytuar mbi bazë objektive dhe të dokumentuar, çka në rastin konkret mungon.

Kriteri i paraqitjes së bilanceve të shoqëruara me akt ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar nuk është kriter që lidhet me madhësinë absolute të fondit limit, por me stabilitetin

financiar dhe strukturën e shëndetit ekonomik të operatorit. Ky është një instrument kontrolli mbi raportin aktiv/pasiv dhe mbi qëndrueshmërinë financiare të subjektit. Në këtë kuptim, ose ky instrument konsiderohet i domosdoshëm për të garantuar zbatimin e kontratës, ose nuk konsiderohet i tillë. Nuk mund të pranohet që e njëjta kontratë shërbimi, me të njëjtin risk profesional dhe me të njëjtat detyrime ligjore për mbrojtjen e shëndetit publik, të kërkojë kontroll të thelluar financiar në një lot dhe jo në një tjetër, pa një arsyetim teknik specifik.

Është e pranueshme që vlera minimale e xhiros të lidhet proporcionalisht me fondin limit të çdo loti. Megjithatë, metodologjia e verifikimit të kapacitetit ekonomik duhet të jetë koherente brenda së njëjtës procedurë. Ndryshimi i metodologjisë duke kërkuar në disa lote vetëm xhiro dhe në të tjera xhiro plus analizë bilanci, krijon standarde të ndryshme pranueshmërie për operatorë që marrin pjesë në të njëjtin proces prokurimi. Kjo cenon jo vetëm parimin e trajtimit të barabartë sipas nenit 3 të ligjit nr. 162/2020, por edhe parimin e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së vendimmarrjes administrative.

Mungesa e kriterit të bilancit në Lotin 1 krijon një situatë objektivist të pabarabartë ndërmjet operatorëve që ofertojnë vetëm në Lotin 1 dhe atyre që ofertojnë në lotet e tjera. Operatorët që marrin pjesë në Lotet 2 - 5 i nënshtrohen një kontrolli më të thelluar financiar, ndërsa operatorët që marrin pjesë vetëm në Lotin 1 i shmangen këtij kontrolli, pavarësisht se natyra e detyrimeve kontraktore mbetet e njëjtë. Kjo krijon një standard të dyfishtë brenda së njëjtës procedurë, pa një bazë të qartë ligjore apo teknike.

Në kuptim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, kërkesat për kualifikim duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Lidhja me objektin nënkupton jo vetëm raportin me vlerën monetare, por edhe me riskun dhe përgjegjësinë që rrjedh nga ekzekutimi i kontratës. Shërbimi i dezinfektimit përfshin përdorimin e produkteve biocide dhe ndërhyrje me ndikim në shëndetin publik, çka kërkon një nivel të caktuar stabiliteti financiar për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit gjatë 24 muajve të marrëveshjes kuadër. Nëse ky stabilitet konsiderohet i domosdoshëm për lotet me vlerë më të lartë, ai nuk mund të konsiderohet i panevojshëm për lotet me vlerë më të ulët, për sa kohë kohëzgjatja dhe natyra e detyrimeve mbeten identike.

Në mungesë të një arsytimi të dokumentuar nga autoriteti kontraktor që të justifikojë diferencimin metodologjik, ky diferencim rezulton arbitrar. Vendimmarrja administrative në fushën e prokurimit publik duhet të jetë e motivuar, e arsyetuar dhe e bazuar në kritere objektive. Çdo dallim në trajtimin e loteve brenda së njëjtës procedurë kërkon një justifikim të qartë teknik dhe financiar, i cili në dokumentet e tenderit nuk rezulton të jetë i shprehur.

Për këto arsye, **diferencimi metodologjik i kriterëve ekonomike ndërmjet Lotit 1 dhe loteve të tjera, në mungesë të një arsytimi objektiv dhe të dokumentuar, cenon parimin e proporcionalitetit, trajtimin të barabartë dhe transparencës, të sanksionuara në nenet 2, 3 dhe 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe përbën shkak të mjaftueshëm për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit në drejtim të unifikimit të standardit të verifikimit të kapacitetit ekonomik.**

Sa më sipër, vendosja e kriterëve nga autoritetet kontraktore duhet të jetë koherente, e arsyetuar dhe e njëjtë për raste të njëjta.

Për këto arsye, kërkojmë modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, duke e shtuar edhe në Lotin 1 kërkesën:

“2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

2. Në lidhje me kriterin teknik:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.”

E vleresojme si një kriter diskriminues dhe kufizues argumentuar si më poshtë:

Duke qenë se procedura për autorizimin e produkteve biocide parashikon afate të zgjatura administrative për shqyrtimin dhe miratimin e dosjes, ajo objektivist nuk përputhen me afatet e zakonshme të procedurave të prokurimit publik. Për pasojë, operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi reale të pajisen me autorizimin brenda një periudhe kaq të shkurtër. Kjo do të thotë se autorizimi nuk është një dokument që merret menjëherë apo brenda një afati të shkurtër, por është rezultat i një procesi administrativ dhe teknik që përfshin shqyrtim formal dhe vlerësim shkencor të dosjes. Vlerësimi i dosjes bëhet në bazë të dokumentacionit të përcaktuar.

Në Kreun 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së

autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimisht se: 1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi;

b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.

d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;

dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuara. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;

e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;

f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.

g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg;

gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;

h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkruar të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

i) Faturën e pagesës së aplikimit.

Ndërkohë, procedurat e prokurimit publik zakonisht parashikojnë afate shumë më të shkurtra për dorëzimin e ofertave. Vendosja e detyrimit që operatori ekonomik të paraqesë autorizimin për të gjitha produktet biocide që në momentin e hapjes së ofertave krijon një barrë administrative **që mund të zgjasë përtej afatit kohor të procedurave tenderuese**, përpara se operatori të dijë nëse do të shpallet fitues.

Kjo krijon një disproporcion të qartë ndërmjet barrës që i ngarkohet operatorit ekonomik në fazën e ofertimit dhe nevojës reale të Autoritetit Kontraktor për të garantuar sigurinë e shërbimit. Kërkesa që operatori ekonomik duhet të paraqesë “AKT Autorizimin e produktit Biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave”, në thelb e trajton autorizimin si një atribut të operatorit ekonomik, ndërkohë që, sipas Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe VKM nr. 933/2020, autorizimi është atribut i produktit biocid dhe jo i subjektit që e përdor atë në kuadër të një shërbimi.

Legjislacioni sektorial i cituar më sipër parashikon se autorizimi jepet për produktin, pas një procesi vlerësimi teknik dhe shkencor mbi përbërjen, efektivitetin dhe sigurinë e tij. Autorizimi lidhet me vendosjen në treg të produktit dhe me përdorimin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, por nuk kushtëzon që çdo operator që e përdor produktin në kuadër të një kontrate shërbimi të jetë vetë mbajtës i autorizimit. Në praktikë, autorizimi mund të jetë në emër të prodhuesit, importuesit apo distributorit të produktit, ndërsa operatori i shërbimit është përdorues i produktit të autorizuar.

Në këtë kuptim, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizimin si kriter kualifikimi në fazën e ofertimit, pa lejuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, krijon një kufizim strukturor të konkurrencës. Ajo favorizon subjektet që janë njëkohësisht importues ose mbajtës të autorizimit, duke përjashtuar operatorë të tjerë që mund të kenë kapacitete të plota teknike dhe profesionale për kryerjen e shërbimit, por që furnizohen me produkte biocide të autorizuar nga subjekte të tjera.

Kjo qasje nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale dhe të mos kufizojnë artificialisht konkurrencën. Nëse qëllimi legjitim i autoritetit kontraktor është garantimi që në ekzekutimin e kontratës do të përdoren vetëm produkte biocide të autorizuar, ky qëllim mund të arrihet përmes mjeteve më pak kufizuese, siç është kërkimi që autorizimi i produktit të paraqitet para nënshkrimit të kontratës ose para fillimit të zbatimit të saj.

Ndalimi absolut i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për këtë kriter, i parashikuar në Dokumentet e Tenderit, përbën një kufizim të pajustificuar të një instrumenti të njohur shprehimisht nga ligji i prokurimit publik. Për sa kohë që autorizimi i produktit nuk është atribut personal i operatorit, por i vetë produktit, ndalimi i mbështetjes në kapacitete të treta nuk justifikohet si “aspekt kritik i kontratës” në kuptimin e nenit 78 të LPP, përveçse nëse provohet se përdorimi i produktit kërkon kontroll të drejtpërdrejtë juridik mbi autorizimin, gjë që nuk rezulton nga legjislacioni sektorial.

Për më tepër, vendosja e këtij kriteri në momentin e hapjes së ofertave, si kusht kualifikues, e zhvendos fokusin nga aftësia reale për të ekzekutuar kontratën në një element formal, i cili mund të sigurohet edhe në fazën e kontraktimit. Prokurimi publik synon të identifikojë operatorin ekonomik më të përshtatshëm për të realizuar shërbimin, jo të kufizojë pjesëmarrjen për arsye që mund të zgjidhen në mënyrë proporcionale gjatë fazës së ekzekutimit.

Në këtë kuadër, kërkesa aktuale përbën një kriter teknik që shkon përtej asaj që është e domosdoshme për garantimin e zbatimit të kontratës dhe bie në kundërshtim me parimet e

konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, ajo duhet të modifikohet në mënyrë që të kërkojë përdorimin e produkteve të autorizuar, pa e kushtëzuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me faktin që autorizimi të jetë në emrin e tyre dhe pa ndaluar mbështetjen në kapacitete të subjekteve të tjera.

Autorizimi është dokument i lidhur me fazën e ekzekutimit, jo me vlerësimin e ofertës, kjo e përcaktuar shumë qartë në nenin 8 të Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”

Neni 8

Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuar, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

a) produkte biocide të prodhuara në vend;

b) produkte biocide të autorizuar në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;

c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuar në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Autorizimi për produktin biocid lidhet me vendosjen në treg dhe përdorimin konkret të produktit. Ai është dokument që garanton se produkti është i sigurt dhe i lejuar për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, në fazën e ofertimit, autoriteti vlerëson kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përvojën e mëparshme, ofertën ekonomike.

Vlerësimi i ofertës nuk kërkon domosdoshmërisht që produktet konkrete të jenë tashmë të autorizuar në momentin e hapjes së ofertave, për sa kohë që operatori angazhohet se do të përdorë vetëm produkte të autorizuar dhe i paraqet këto autorizime përpara fillimit të zbatimit të kontratës.

Kërkesa aktuale e zhvendos një detyrim që i përket fazës së ekzekutimit në fazën e ofertimit, duke e kthyer atë në kriter eliminues, çka shkon përtej asaj që është e nevojshme për vlerësimin e ofertës.

Autoriteti kontraktor në këtë mënyrë ngushton rrethin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me nenin 3 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”. Kjo sjell kufizim të konkurrencës dhe ulje të numrit të operatorëve pjesëmarrës, pa qenë e domosdoshme për garantimin e interesit publik.

Në vijim të argumentimit të paraqitur lidhur me kërkesën për paraqitjen e AKT Autorizimit të produktit biocid, çmujmë të nevojshme të theksojmë se thelbi i problematikës në rastin konkret nuk qëndron vetëm në ekzistencën e autorizimit si dokument formal, por në mënyrën se si është konceptuar dhe përdorur kërkesa për Autorizim Importi në raport me historikun e kësaj procedure dhe me misionin teknik të vetë shërbimit të kërkuar.

Duhet theksuar se autorizimi i importit, sipas legjislacionit për produktet biocide, është një akt administrativ që lidhet me hyrjen në territor të një produkti të caktuar dhe me kontrollin e dokumentacionit teknik që shoqëron produktin. Ky autorizim nuk është garanci në vetvete për përshtatshmërinë e produktit ndaj organizmave target të kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit. Përkundrazi, përmbajtja teknike e autorizimit varet nga dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi dhe nga vlerësimi formal-administrativ i kryer nga autoriteti kompetent.

Precedenti i procedurës së vitit 2023 për shërbimin e dezinfektimit tregon qartazi se Autorizimi i Importit është përdorur për të “mbuluar” përdorimin e një produkti (Aquabac), i cili nuk rezultonte i përshtatshëm për organizmat target të kërkuar në DST. Pra, ekzistenca e autorizimit nuk garantoj përputhshmërinë reale teknike të produktit me kërkesat e tenderit. Përkundrazi, ai u përdor si instrument formal për të legjitimuar përdorimin e një produkti që, në substancë, nuk përmbushte misionin teknik të ndërhyrjes.

Ky precedent është thelbësor në analizën e proporcionalitetit të kriterit aktual. Nëse autorizimi i importit nuk garanton automatikisht përputhshmërinë teknike të produktit me organizmat target, atëherë kërkesa për paraqitjen e tij si kriter kualifikimi nuk është mjet i përshtatshëm për arritjen e qëllimit legjitim (mbrojtja e shëndetit publik dhe efektiviteti i ndërhyrjes). Një kriter që nuk është i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të deklaruar bie ndesh me testin e proporcionalitetit.

Ndryshimi i DST-së në këtë mënyrë nuk është thjesht një riformulim teknik, por përbën një devijim substancial nga kërkesat reale të misionit të ndërhyrjes dhe nga kuadri ligjor i produkteve biocide. **Heqja ose relativizimi i elementeve thelbësore që lidhen me organizmat target, me tipologjinë e formulimit dhe me përputhshmërinë me përdorimin në zona bregdetare krijon një hapësirë të pajustificuar për interpretim, duke mundësuar që një produkt si Aquabac e etj, të paraqitet si i përshtatshëm, edhe pse në përmbajtje nuk përmbush kërkesat specifike të kontrollit të organizmave të dëmshëm të përcaktuar në DST.**

Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 95/2015, autorizimi i produktit biocid është i lidhur ngushtësisht me përshkrimin e saktë të përdorimit, me organizmat target dhe me dozimin e aplikimit. Pra, autorizimi nuk është një dokument abstrakt, por një akt që mbështetet mbi parametra teknike konkrete. Nëse DST modifikohet në mënyrë që të mos kërkojë përputhje të qartë midis organizmave target të përcaktuar në dosjen e autorizimit dhe atyre të kërkuar në tender, atëherë krijohet një shkëputje artificiale midis autorizimit formal dhe efektivitetit real biologjik të produktit.

Autorizimi i produktit biocid jepet mbi bazën e një dosjeje që përmban përdorimin e deklaruar, organizmat target të specifikuar dhe dozat e aplikimit. Pra, autorizimi është i kushtëzuar nga një fushë përdorimi e caktuar. Nëse DST nuk kërkon përputhje eksplicite midis organizmave target të autorizimit dhe organizmave target të tenderit, atëherë **autorizimi mbetet një dokument formal që provon se produkti është “i lejuar për treg”, por jo domosdoshmërisht se është i autorizuar për atë përdorim konkret.**

Autorizimi vlerëson sigurinë dhe efektivitetin në raport me parametrat e paraqitur nga aplikuesi. Nëse produkti është autorizuar për një spektër të caktuar organizmash (p.sh. larva të caktuara në kushte të kontrolluara), por tenderi kërkon ndërhyrje ndaj organizmave të tjerë ose në kushte specifike (zona bregdetare, ekspozim ndaj kripës, temperatura të larta, dinamika të veçanta ekologjike), atëherë mungesa e kërkesës për përputhje direkte krijon një boshllëk teknik. **Produkti mund të jetë i autorizuar, por jo i testuar dhe i provuar për situatën konkrete.**

Nëse DST kërkon vetëm “AKT Autorizimin” pa kërkuar që përmbledhja e karakteristikave të produktit të përfshijë saktësisht organizmat target të tenderit, atëherë verifikimi i autoritetit kontraktor mbetet sipërfaqësor. Autoriteti kontrollon ekzistencën e autorizimit, por jo përmbajtjen teknike të tij. Kështu krijohet ajo që në analizë juridike konsiderohet “shkëputje midis formës dhe substancës”: forma (autorizimi ekziston) plotësohet, por substanca (efektiviteti real për objektin e kontratës) nuk provohet. Kjo situatë krijohet shpesh kur kriteri

teknik është konceptuar si kriter formal kualifikimi dhe jo si kriter i lidhur drejtpërdrejt me performancën e kontratës. **Autorizimi trajtohet si dokument administrativ që “mbyll” kontrollin ligjor, ndërkohë që ai në vetvete nuk është provë e mjaftueshme për përshtatshmërinë biologjike për një ndërhyrje specifike.**

Në kontekstin e precedentit të vitit 2023, kjo shkëputje ndodh sepse autorizimi i importit u përdor si mburojë formale për të legjitimuar një produkt që, në thelb, nuk përmbushte kërkesat teknike të misionit të ndërhyrjes. Pra, mungesa e lidhjes së detyrueshme midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të DST-së e bëri të mundur që produkti të kalojë filtrin formal të kualifikimit pa provuar efektivitetin real.

Në thelb, kjo ndodh sepse autorizimi provon lejen për treg, por jo domosdoshmërisht përshtatshmërinë për një përdorim specifik, DST, nëse nuk kërkon përputhje të drejtpërdrejtë teknike, redukton kontrollin në verifikim formal, vlerësimi zhvendoset nga analiza e përmbajtjes në kontroll të ekzistencës së dokumentit, duke krijuar mundësinë që një produkt të jetë ligjërisht i autorizuar, por teknikisht i papërshtatshëm për objektin konkret të kontratës.

Prandaj, nëse nuk kërkohet përputhje eksplicite midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të përcaktuar në DST, krijohet një hendek midis autorizimit formal dhe efektivitetit real biologjik, që cenon parimin e lidhjes së drejtpërdrejtë të kriterit me objektin e kontratës dhe rrezikon interesin publik.

Në këtë kontekst, ndryshimi i DST-së ka efekt të dyfishtë problematik, nga njëra anë, zhvendos fokusin nga përputhshmëria teknike reale tek ekzistenca e një autorizimi formal, nga ana tjetër, ul nivelin e transparencës mbi përbërjen, formulimin dhe fushën e aplikimit të produktit. Kjo situatë bie ndesh me parimin e transparencës dhe të konkurrencës së ndershme, pasi operatorët ekonomikë nuk konkurrojnë mbi baza të qarta dhe të krahasueshme teknike, por mbi dokumente formale që mund të mos reflektojnë realisht përputhshmërinë me misionin e kontratës.

Fakti që përdorimi i produktit Aquabac dhe dokumentacioni shoqërues i tij është bërë objekt i hetimeve nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) për shkak të dyshimeve mbi mospërputhje me kërkesat ligjore dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, përbën një element objektiv që autoriteti kontraktor nuk mund ta injorojë. Edhe pse hetimi penal nuk përbën në vetvete provë përfundimtare për fajësi, ekzistenca e tij është një tregues serioz që kërkon rritje të nivelit të kontrollit teknik dhe jo ulje të tij përmes formulimeve të përgjithshme në DST.

Në kushtet kur ekziston një precedent konkret ku autorizimi i importit është përdorur për të legjitimuar një produkt që nuk përmbushte në thelb kriteret teknike të ndërhyrjes, çdo formulim i ri i DST-së që zbeh lidhjen midis organizmave target, dozimit, formulimit

dhe përdorimit konkret në zonat bregdetare krijon rrezik real për efektivitetin e shërbimit dhe për shëndetin publik. Autoriteti kontraktor ka detyrimin pozitiv për të garantuar që produkti i përdorur të jetë jo vetëm i autorizuar formalisht, por i përshtatshëm në mënyrë të provueshme për kushtet konkrete të aplikimit.

Në këtë kuptim, mungesa e transparencës mbi të dhënat reale teknike, si përbërja cilësore dhe sasiore e lëndëve vepruese, spektri i veprimit ndaj organizmave target specifikë të zonave bregdetare, dhe përputhshmëria me tipologjinë e ndërhyrjes së kërkuar, cenon drejtpërdrejt parimin e proporcionalitetit dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të kriterit me objektin e kontratës, në kuptim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020.

Për më tepër, lejimi i konsiderimit si “i përshtatshëm” i një produkti që nuk përmbush kuadrin ligjor dhe teknik të biocideve për përdorimin konkret në zonat bregdetare përbën rrezik jo vetëm për efektivitetin e ndërhyrjes, por edhe për mjedisin dhe për shëndetin publik. Kjo e zhvendos çështjen nga një debat formal mbi kriteret e kualifikimit në një çështje të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së interesit publik.

Për rrjedhojë, ndryshimi i DST-së në mënyrën aktuale nuk mund të konsiderohet neutral apo teknikisht i justifikuar, por përbën një devijim që krijon mundësi reale për përfshirjen në procedurë të produkteve që nuk përmbushin standardet ligjore dhe shkencore të kërkuara. Në këto kushte, **autoriteti kontraktor duhet të rikthejë formulimin e qartë dhe të detajuar të kërkesave teknike, duke kërkuar përputhshmëri të drejtpërdrejtë midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të përcaktuar në DST, si dhe dokumentacion teknik provues mbi efektivitetin në kushtet konkrete të aplikimit, si autorizim prodhuesi, letër aksesi, certifikatë regjistrimi në një nga vendet e BE-së, USA, Zelandë e Re, Japoni, etj.**

Vetëm një formulim i tillë garanton transparencë, konkurrencë të ndershme dhe mbrojtje reale të interesit publik, duke shmangur përsëritjen e situatave të vitit 2023 dhe duke siguruar që procedura të mos përdoret për të legjitimuar produkte që në thelb nuk përmbushin kriteret teknike të kërkuara.

Kriteri që kërkon paraqitjen e AKT Autorizimit të produktit biocid në momentin e hapjes së ofertave nuk përmbush kërkesën e nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, në lidhje me testin e lidhjes së drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, pasi objekti i kontratës është ofrimi i shërbimit të dezinfektimit dhe jo importimi apo vendosja në treg e produktit. **Autorizimi është atribut i produktit dhe lidhet me legjitimitetin e tij për t’u përdorur në territor, ndërsa vlerësimi i ofertës duhet të fokusohet në kapacitetin teknik, profesional dhe organizativ të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin. Vendosja e këtij dokumenti si kriter eliminues në fazën e ofertimit krijon një shkëputje ndërmjet kërkesës dhe aftësisë reale**

për ekzekutimin e kontratës, duke e zhvendosur thelbin e vlerësimit nga performanca e pritshme e shërbimit në një element formal që nuk provon në vetvete kapacitetin teknik të operatorit.

Sa i përket ndryshimit të praktikës administrative dhe aplikimit të dy standardeve, fakti që për të njëjtën kategori shërbimi në vitet e mëparshme, përfshirë procedurat e zhvilluara që nga viti 2014, nuk është kërkuar autorizimi i importit si kriter kualifikues, ndërkohë që kontratat janë realizuar me përpikmëri dhe pa probleme në zbatim, tregon mungesë koherence në veprimtarinë e autoritetit kontraktor. Ndryshimi i standardit pa një analizë të dokumentuar teknike dhe pa një arsyetim objektiv cenon parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërisë së ligjshme të operatorëve ekonomikë, si dhe krijon dyshim të arsyeshem mbi neutralitetin e kriterit të vendosur, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

Në aspektin e efektit strukturor në treg, kërkesa për paraqitjen e autorizimit në momentin e hapjes së ofertave krijon një barrierë hyrjeje që favorizon subjektet që janë njëkohësisht importues ose mbajtës të autorizimeve për produkte specifike, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë që kanë kapacitete të plota për kryerjen e shërbimit, por që furnizohen nga tregu i brendshëm me produkte të autorizuara. Një kriter i tillë, në praktikë, mund të ngushtojë artificialisht rrethin e operatorëve pjesëmarrës dhe të krijojë efekt mbyllës të tregut, duke rrezikuar konkurrencën efektive dhe duke rritur kostot për autoritetin kontraktor, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 162/2020.

Nga pikëpamja e proporcionalitetit në kuptimin e ngushtë, kriteri aktual nuk respekton testin e mjetit më pak kufizues. Nëse qëllimi legjitim i autoritetit kontraktor është të garantojë përdorimin e produkteve biocide të autorizuara dhe të shmangë situata të ngjashme me precedentët problematikë të së kaluarës, ky qëllim mund të arrihet përmes mjeteve më pak kufizuese, si paraqitja e autorizimit nga operatori i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara fillimit të zbatimit të saj. Vendosja e këtij dokumenti si kriter eliminues në fazën e ofertimit tejkalon atë që është e nevojshme për garantimin e interesit publik dhe përbën barrë të panevojshme administrative dhe financiare për operatorët ekonomikë.

Duke pasur parasysh se precedenti i vitit 2023 lidhur me përdorimin e produktit Aquabac dhe dokumentacionin përkatës është bërë objekt hetimi nga Prokuroria e Posaçme, autoriteti kontraktor ka një detyrim të shtuar për të rritur nivelin e kontrollit substancial mbi përputhshmërinë teknike reale të produkteve me organizmat target dhe kushtet konkrete të aplikimit, dhe jo për ta reduktuar kontrollin në verifikimin formal të ekzistencës së një akti administrativ. Formulimi aktual i kriterit, i cili nuk kërkon përputhje të drejtpërdrejtë midis

përmbajtjes së autorizimit dhe kërkesave teknike të DST-së, krijon rrezik për përsëritjen e problematikave të mëparshme dhe për cenimin e efektivitetit të shërbimit, duke e bërë të domosdoshme rishikimin e tij në funksion të mbrojtjes së interesit publik dhe transparencës së procedurës.

Fakti që në procedurat e mëparshme të së njëjtës kategori, përfshirë ato të viteve 2014 e në vijim, autorizimi i importit nuk është kërkuar si kriter kualifikues, ndërkohë që kontratat janë zbatuar me përpikmëri dhe realizim të plotë, dëshmon se ky dokument nuk ka qenë i domosdoshëm për garantimin e ekzekutimit të kontratës. Kjo krijon një situatë të qartë të mungesës së koherencës administrative dhe cenon parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërisë së ligjshme.

Një autoritet kontraktor nuk mund të ndryshojë standardin e kërkesave pa një arsyetim objektiv dhe të dokumentuar, sidomos kur bëhet fjalë për një procedurë të përsëritur në kohë dhe për një kategori shërbimi të konsoliduar. Ndryshimi i standardit pa motivim teknik krijon dyshim të arsyeshëm mbi neutralitetin e kërkesës dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë.

Nëse kërkesa për autorizim importi paraqitet si mjet për të siguruar transparencë mbi përbërjen dhe cilësitë e produktit, atëherë ky qëllim mund të arrihet përmes mekanizmave më të drejtpërdrejtë dhe më pak kufizues, si kërkimi i dosjes teknike të produktit, kërkimi i dokumentacionit mbi efektivitetin ndaj organizmave target, apo verifikimi teknik nga TAECHS ose nga struktura kompetente e ISHP.

Pra, nëse qëllimi është garantimi i përshtatshmërisë biologjike të produktit, atëherë duhet kërkuar dokumentacioni teknik për efektivitetin ndaj organizmave target, jo një autorizim importi që mund të jetë marrë mbi bazë dokumentacioni të diskutueshëm ose madje të falsifikuar, siç rezulton të jetë nën hetim nga SPAK për procedurën e vitit 2023.

Precedenti i vitit 2023, ku autorizimi i importit ka rezultuar i lidhur me përdorim të dokumentacionit të falsifikuar për përfitimin e tenderit dhe ku për këtë çështje është paraqitur kallëzim penal dhe vijon hetimi nga Prokuroria e Posaçme, forcon argumentin se autorizimi i importit, si kriter formal, nuk është garanci për ligjshmërinë dhe cilësinë e produktit. Përkundrazi, ai mund të përdoret si mburojë formale për të maskuar probleme substanciale teknike. Kjo situatë e bën edhe më të domosdoshme që kriteri të fokusohet në përputhshmërinë reale teknike të produktit me organizmat target dhe me misionin e ndërhyrjes, jo në ekzistencën e një akti administrativ formal.

Kërkesa për autorizim importi, në kushtet kur nuk është kërkuar historikisht dhe kur kontratat janë realizuar me sukses, krijon një standard të ri që kufizon aksesin në treg për operatorë që përdorin produkte të autorizuara tashmë në territor, por që nuk janë vetë

importues. Kjo kufizon konkurrencën në favor të subjekteve që kanë kontroll mbi zinxhirin e importit dhe krijon avantazh strukturor të padrejtë.

Nga analiza e dokumentacionit teknik dhe ligjor të produkteve biocide që mund të paraqiten në kuadër të kësaj procedure, rezulton se ekziston një mospërputhje thelbësore midis statusit formal të autorizimit dhe përmbushjes reale të kërkesave ligjore dhe teknike të përcaktuara në legjislacionin shqiptar dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit. Konkretisht, në rast se produkti paraqitet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai nuk mund të përmbushë kushtet për autorizim dhe regjistrim në Republikën e Shqipërisë, për shkak se lënda aktive përkatëse nuk rezulton e përfshirë në listën e substancave të miratuara sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020, i cili përcakton kriteret dhe procedurat për autorizimin e produkteve biocide dhe përfshirjen e lëndëve aktive të lejuara për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, një produkt i mbështetur mbi këtë bazë dokumentare nuk përmbush kushtet ligjore për t'u konsideruar produkt biocid i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nga ana tjetër, në rast se produkti paraqitet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet franceze, analiza teknike eidenton se autorizimi nuk është i lidhur drejtpërdrejt me prodhuesin origjinal të produktit ose nuk garanton përputhshmëri të plotë me formulimin dhe përdorimin e kërkuar, ndërkohë që lënda aktive e përdorur, edhe nëse konsiderohet teknikisht ekuivalente, nuk garanton efikasitet biologjik kundër të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave që përbëjnë objektin e ndërhyrjes sipas specifikimeve teknike të DST-së. Në këto kushte, ekzistenca e një autorizimi formal nuk provon në vetvete përmbushjen e kërkesave funksionale dhe teknike të kontratës, të cilat kërkojnë qartësisht kontroll efektiv dhe të plotë të organizmave target.

Në këtë kontekst, formulimi aktual i DST-së, i cili redukton kontrollin teknik dhe ligjor vetëm në ekzistencën e një akti autorizimi, krijon një hapësirë të pajustificuar interpretimi në fazën e vlerësimit të ofertave dhe nuk garanton verifikimin e plotë të përputhshmërisë së produktit me kërkesat ligjore dhe teknike. Ndryshe nga procedurat e mëparshme, ku kërkohej dokumentacion i plotë teknik dhe ligjor që i mundësonte autoritetit kontraktor të kryente një vlerësim të plotë mbi përbërjen, efektivitetin dhe përshtatshmërinë e produktit, formulimi aktual kufizon kontrollin në një dokument të vetëm formal, mbi bazën e të cilit nuk mund të verifikohet në mënyrë të plotë përputhshmëria reale e produktit me objektin e kontratës.

Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimet themelore të prokurimit publik, në veçanti parimin e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë, pasi krijon mundësinë që produkte të cilat nuk përmbushin plotësisht kërkesat teknike të konsiderohen të pranueshme

vetëm mbi bazën e ekzistencës së një autorizimi formal, pa u verifikuar përmbajtja dhe fushëveprimi real i këtij autorizimi. Për më tepër, kjo situatë cenon edhe parimin e sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të përcaktojnë me qartësi kriteret reale mbi të cilat do të vlerësohet përputhshmëria teknike e produkteve të ofruara.

Në kushtet aktuale, produkti është autorizuar në Republikën e Shqipërisë, çka nënkupton se autorizimi është mbështetur mbi dokumentacion të paraqitur nga një juridiksion i huaj, konkretisht dokumentacion francez. Megjithatë, analiza teknike e karakteristikave të produktit dhe e fushës së përdorimit të tij evidenton se ai nuk garanton efikasitet të plotë kundër të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave që përbëjnë objektin e ndërhyrjes sipas specifikimeve teknike të procedurës. Në këto kushte, autorizimi formal nuk mund të konsiderohet provë e mjaftueshme për përputhshmërinë me kërkesat teknike të kontratës, pasi ligji dhe dokumentet e tenderit kërkojnë jo vetëm ekzistencën e autorizimit, por edhe përputhshmërinë funksionale dhe teknike me objektin konkret të ndërhyrjes.

Autorizimi administrativ i një produkti biocid nuk mund të prevalojë mbi detyrimin ligjor të autoritetit kontraktor për të garantuar që produkti i përdorur përmbush plotësisht specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Nëse produkti nuk garanton kontroll efektiv të të gjitha organizmave target të përcaktuar në specifikimet teknike, atëherë ai nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për realizimin e objektit të kontratës, pavarësisht ekzistencës së një autorizimi formal.

Për më tepër, formulimi aktual i DST-së ka efektin praktik të fshehjes ose relativizimit të të dhënave reale teknike dhe ligjore mbi produktin Aquabac, duke krijuar një situatë konfuzioni dhe mungese transparence në procesin e vlerësimit. Kjo krijon mundësinë që një produkt që nuk përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe teknike të konsiderohet i pranueshëm në procedurë, në kundërshtim me qëllimin e ligjit për prokurimin publik dhe me interesin publik për garantimin e efektivitetit të ndërhyrjes. Ky aspekt merr rëndësi të veçantë edhe për faktin se përdorimi i këtij produkti dhe dokumentacioni përkatës kanë qenë objekt hetimi nga organet kompetente, çka nënvizon nevojën për një nivel më të lartë transparence dhe verifikimi teknik, dhe jo për reduktimin e standardeve të kontrollit përmes formulimeve të përgjithshme në DST. Në këto kushte, lejimi i përdorimit të një produkti që nuk provon në mënyrë të qartë përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe ligjore nuk është i justifikueshëm dhe bie në kundërshtim me detyrimin e autoritetit kontraktor për të garantuar realizimin efektiv dhe të ligjshëm të kontratës.

Në këtë kuptim, kërkesa për autorizim importi duhet të vlerësohet jo vetëm si kriter teknik, por si kriter me efekt potencial diskriminues, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Për të gjitha këto arsye, kërkesa për Autorizim Importi, si kriter kualifikues në fazën e ofertimit, rezulton e panevojshme në raport me historikun e procedurës, e papërshtatshme për garantimin e përputhshmërisë teknike reale, e pajustificuar në mungesë të një arsytimi të dokumentuar dhe potencialisht kufizuese dhe diskriminuese në raport me operatorë që nuk janë vetë importues.

Referuar nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, kriteret e kualifikimit duhet të jenë:

- të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës
- proporcionale
- të nevojshme për garantimin e kapaciteteve të OE

Për rrjedhojë, në kuadër të këtij ankimi, kërkojmë heqjen e kërkesës për Autorizim Importi si kriter kualifikimi, duke e zëvendësuar atë me kërkesë për dokumentacion teknik që provon efektivitetin dhe përshtatshmërinë e produktit ndaj organizmave target të përcaktuar në DST, në mënyrë që të garantohet realisht misioni i ndërhyrjes dhe të ruhet konkurrenca e ndershme në treg.

Për sa më sipër, kërkojmë:

- Pranimin e ankesës si të ligjshme dhe të bazuar;
- Pezullimin e procedurës së prokurimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar;
- Shtimin dhe ndryshimin e kriterëve të kundërshtuar në DST;
- Detyrimin e Autoritetit Kontraktor për përputhjen e dokumentacionit me ligjin.

II.5. Me shkresën nr. 686/10 prot., datë 25.02.2026 me lëndë “Mbi shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga operatori ekonomik “NRG” SHPK lidhur me dokumentet e tenderit, në procedurën e prokurimit me nr. REF-76055-02-12-2026, me objekt “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane e ndarë në 5 (pesë) lote” protokolluar me tonën me nr. 548/2 prot., datë 26.02.2026 autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP vendimin për shqyrtimin e ankesës “Vendim K.SH.A 29/2026” datë 25.02.2026 ku ka vendosur mos pranimin e saj duke argumentuar:

II

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit të vendosur në dispozicion nga Njësia e Prokurimit si dhe dokumentacionit të ngarkuar në SPE,

ARSYETON:

II.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit “NRG” shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, për procedurën e prokurimit me objekt: Loti I “Shërbim dezinfektimi në zonat

bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”, ku argumenton shtimin e kërkesës për kualifikim për paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore, KSHA arsyeton se:

Në Dokumentat Standarte të Tenderit, të publikuara për procedurën e prokurimit objekt ankimi, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.2.1, është kërkuar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM” mbajtur më datë 12.02.2026 dhe publikuar në SPE më datë 13.02.2026, nga ana e Autoritetit Kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Kriteri i pikës 2.2.1 është vendosur referuar nenit 43, pika 2/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku është përcaktuar qartë vlera e kërkuar për xhiron minimale vjetore, dhe pikës 3 të nenit 77 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe Rekomandimit të APP-së nr7998 date 24.12.2021. Vlera e kërkuar është brenda kufijve të vendosur në dispozitat më sipër, dhe është vendosur me qëllim që AK të sigurohet për potencialin ekonomiko-financiar të OË ofertues, që lidhet drejtëpërdrejtë me qëndrueshmërinë dhe vijimësinë e veprimtarisë së operatorëve ekonomikë në treg, si një element i rëndësishëm në realizimin e objektit të prokurimit dhe përmbushjes së detyrimeve kontraktore.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenit 43, pika 1, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. AK në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” si dhe kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në Nenin 2 “Qëllimi” të Ligjit Nr. 162/2021 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në Nenin 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit Nr. 162/2021 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprimet me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

Në Nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2021 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), parashikohet se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), Kreu V, Seksioni III, Neni 43, parashikohet se:

“1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit⁴³, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar; b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkojnë bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritjet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, pasi mori në shqyrtim dokumentet e tenderit, procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, për këtë procedurë prokurimi, të publikuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik si dhe ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues "NRG" shpk, konstaton se ky pretendim lidhet me shtimin e kërkesave për kualifikim, në rastin konkret shtimin e kërkesës për paraqitjen e pasqyrave financiare/bilanceve vjetore.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se objekti i këtij pretendimi të parashtruar nga Operatori ekonomik ankimues nuk përbën në vetvete kundërshtimin ndaj një akti apo vendimmarrjeje të Autoritetit Kontraktor, i cili në zbatim të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, ndër të tjera ka hartuar dhe kriteret ekonomiko-financiare për kualifikim dhe konkretisht paraqitjen e xhiros vjetore. Por konsiston në kërkesën për vendosjen/shtimin e një specifike të re lidhur me këtë kriter që në thelb përbën shtimin e një kërkesë për kualifikim të ndryshme nga ato të parashikuara në dokumentet e tenderit. Një kërkesë e tillë nuk mbështetet në kuadrin ligjor në fuqi dhe tejkalon të drejtën e ankimit të parashikuar, konkretisht sipas Nenit 109 "E drejta e ankimit", pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), ku citohet se: "Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit ose entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankojë pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik".

Sipas parashikimeve të sipërcituara, e drejta e ankimit synon të garantojë mbrojtjen e interesave ligjore të Operatorëve ekonomikë në rastet kur Autoriteti Kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin, në rastin konkret duke vendosur kritere diskriminuese, joproporcionale, të paarsyetuara ose të hartuara në kundërshtim me formën dhe përmbajtjen e kërkuar nga legjislacioni. E drejta e ankimit nuk shtrihet deri në atë masë sa t'u japë Operatorëve ekonomikë të interesuar apo edhe ankimues, kompetencën për të diktuar përmbajtjen e kritereve të kualifikimit apo për të imponuar kushte shtesë për pjesëmarrje dhe ofertim në procedurën e prokurimit.

Përcaktimi i kritereve të kualifikimit është kompetencë ekskluzive e Autoritetit Kontraktor, i cili, në ushtrim të kësaj kompetence, vlerëson nevojat konkrete të kontratës, natyrën dhe volumin e saj, si dhe nivelin e kapacitetit teknik, profesional dhe financiar të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Ndërhyrja e Operatorëve ekonomikë në këtë proces, përmes kërkesave për shtimin e

kritereve të reja, do të cenonte autonominë vendimmarrëse si dhe diskrecionin e Autoritetit Kontraktor dhe njëkohësisht do të ishte në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik.

Për më tepër, shtimi i kritereve të reja të kualifikimit, sipas kërkesës së ankimesit, do të përbente vendosjen e kushteve më të ndërlikuara për pjesëmarrje në procedurë, të cilat nuk janë parashikuar fillimisht në dokumentet e tenderit. Kjo do të sillte një ndryshim thelbësor të kushteve të pjesëmarrjes, duke rrezikuar çënimin e parimeve të barazisë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës midis subjekteve të interesuara, pasi Operatorë ekonomik të tjerë të interesuar mund të përjashtohen ose të vendosen në pozita të pafavorshme, pa një arsye objektive dhe të justifikuar ligjërisht.

Gjithashtu, refuzimi i një ankese që synon shtimin e kërkesave të reja për kualifikim është një praktikë vendimmarrëse administrative e konsoliduar, edhe nga organi më i lartë i shqyrtimit dhe trajtimit të ankesave, Komisioni i Prokurimit Publik, dhe e kundërta, do të krijonte një precedent të rrezikshëm, pasi do të lejonte që procedurat e prokurimit të modifikoheshin në varësi të interesave subjektive të Operatorëve ekonomikë të veçantë, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe vetë stabilitetin e dokumenteve të tenderit. Dokumentet e tenderit duhet të jenë të qarta, të plota dhe të pandryshueshme në thelb gjatë zhvillimit të procedurës prokurimit, duke garantuar në këtë mënyrë transparencë dhe besueshmëri tek Operatorët ekonomik ofertues gjatë procesit të prokurimit.

Në këtë kuadër, çdo pretendim i ankimesit "NRG" shpk, duhet të kufizohet në verifikimin e ligjshmërisë së kritereve ekzistuese të kualifikimit, siç janë proporcionaliteti i tyre me objektin e kontratës, mungesa e karakterit diskriminues apo përputhshmëria me kërkesat formale të ligjit. Kërkesat që synojnë shtimin apo riformulimin e kritereve të kualifikimit përtej atyre të përcaktuara dhe parashikuara nga Autoriteti Kontraktor nuk përbëjnë objekt të ligjshëm ankimi dhe, për rrjedhojë, nuk mund të pranohen.

Për më tepër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se kërkesat ligjore, ekonomike, teknike të përcaktuara në dokumenteve të tenderit janë vendosur në mënyrë propocionale me natyrën e shërbimit të kërkuar, vlerën e fondit limit, karakteristikat e zonës ku do të ushtrohet shërbimi si dhe duke mbajtur në konsideratë parashikimet ligjore për prokurimin publik në fuqi. KSHA citon se në kuadër të prokurimit publik, ndarja e një kontrate në lote nuk është thjesht një ndarje formale apo organizative, por përfaqëson ndarje reale të objektit të prokurimit në pjesë të pavarura, për rrjedhojë, çdo lot duhet të konsiderohet si një procedurë më vete për qëllime të vlerësimit, kualifikimit dhe shpalljes së fituesit. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Neni 42, parashikohet se: *"Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti/enti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit"*, pra, çdo lot ka objekt të përcaktuar, fond limit të veçantë dhe specifikime teknike të diferencuara. Operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ofertojnë për një, disa apo të gjitha lotet, por vlerësimi i ofertës bëhet në mënyrë të pavarur për secilin lot. Konkretisht për procedurën e prokurimit me objekt: *Loti 1: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër"*, me fond limit 6,036,000 (gjashtë milion e tridhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH ose 62,582 (gjashtëdhjetë e dy mijë e pesëqind e tetëdhjetë e dy) euro pa TVSH, kërkesat ekonomike dhe financiare janë vendosur në përputhje me parashikimet e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (i ndryshuar), Neni 54, pika 4, ku ndër të tjera citohet se: *".....Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të*

realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave....”

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimes nuk qëndron.

II.2. Lidhur me pretendimin e ankimesit “NRG” shpk mbi modifikimin e Dokumenteve të Tenderit, për procedurat e prokurimit me objekt: *Loti 1: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër” Loti 2: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë”, Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës”, Loti 4: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier”, Loti 5: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”,* lidhur me kërkesën për paraqitjen e autorizimit për produktet biocide..., KSHA arsyeton se:

Referuar Dokumenteve të Tenderit të publikuara për procedurat e prokurimit objekt ankimi, në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, pika 2.3.2, është kërkuar:

2.3.2 *“Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi , e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave”.*

Në procesverbalin “PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM”, mbajtur më datë 12.02.2026 dhe publikuar në SPE më datë 13.02.2026, nga ana e Autoritetit Kontraktor është argumentuar vendosja e këtij kriteri kualifikues si më poshtë vijon:

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.*

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 21 pika 4 dhe Nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e Akt-Autorizimit të produktit biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, është e domosdoshme për garantimin e ligjshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së shërbimit objekt prokurimi. Shërbimet e dizinfektimit përfshijnë përdorimin e produkteve biocide, të cilat, për shkak të përbërjes së tyre kimike, mund të paraqesin rrezik për shëndetin e njeriut, kafshët dhe mjedisin, nëse nuk janë të kontrolluara dhe të miratuara nga autoritetet kompetente. Disponimi i këtij dokumenti garanton cilësinë e realizimit të shërbimit si dhe përdorimin/aplikimin e produkteve biocide konform standardeve dhe rregullave për vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre në habitate të caktuara.

Ky kriter siguron që operatori ekonomik përdor vetëm produkte biocide të autorizuar, të testuara dhe të vlerësuara për efektivitet dhe siguri, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, ai garanton që shërbimi i ofruar është profesional dhe realizohet sipas standardeve të kërkuara nga institucionet përgjegjëse për shëndetin publik.

Në Shtojcën 6 të dokumenteve të tenderit është përcaktuar se:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]
FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE
(I njëjtë për të gjitha lotet)

I. Të dhëna të përgjithshme

Procesi i dezinfektimit të mushkonjave do të bazohet në një program parandalimi dhe kontrolli, i cili synon uljen e dendësisë së mushkonjave në zonat e përzgjedhura nëpërmjet kontrollit të larvave me larvicide dhe/ose barriera fizike, apo nëpërmjet eliminimit të vatrave të zhvillimit të mushkonjave në fazën ujore.

Avantazhet që paraqet kontrolli në fazën ujore:

- larvat kapen më lehtë pasi ato nuk mund të largohen nga vendi i zhvillimit /vatra me ujë;
- larvat brenda vatrës ose zonës me ujë qëndrojnë të izoluar aty për një kohë relativisht të gjatë (nga 7 deri në 14 ditë);
- mund të trajtohen në çdo kohë;
- në një zonë të vogël, të kufizuar mund të jenë të përqendruara një numër i madh larvash;
- efekti i larvicideve ka një kohëzgjatje të madhe krahasuar me adulticidet: larvave të sapoçelura nga vezët, u nevojiten zakonisht mesatarisht deri në dy javë që të realizojnë plotësisht ciklin e tyre të zhvillimit në ujë dhe të dalin në fluturim, periudhë në të cilën larvicidi vazhdon efektin e tij, ndërsa aplikimi i adulticidit mund të jetë i nevojshëm të përsëritet brenda 24 orëve, për shkak të emigrimit të mushkonjave në territorin përreth.

Sipërfaqet që do të trajtohen do të jenë me ujë dhe me larva të mushkonjave në habitate që përfshijnë laguna, parqe (vatra të përhershme dhe/ose të përkohshme), kanale, pellgje, puseta dhe bodrume, etj. Trajtimet do të kryhen bazuar në specifikimet teknike, gjetjet dhe konfirmimet e pranisë së larvave në terren me anë të monitorimit entomologjik, para çdo trajtimi.

Në zonat urbane shqetësim përbëjnë kryesisht mushkonjat e gjinisë *Aedes* dhe *Culex* të cilat njihen edhe për rolin e tyre vektorial në transmetimin e patogjenëve si virusin e Nilit Perëndimor (ENV), virusin Chikungunja, Dengue, ZIKA etj. ndërsa në zonat bregdetare gjithashtu edhe ato të gjinisë *Anopheles* (vektor të malarisë), *Aedes* (*Ochlerotatus*) që shkaktojnë shumë bezdisje me pickimet e tyre sidomos në muzg, etj.

II. Llojet e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave dhe specifikimet teknike sipas habitateve

A. Trajtime periodike me larvicide në Zona të Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra të përkohshme dhe të përhershme në laguna, parqe, kanale, pellgje etj, sipas zonave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Trajtimet kryhen, në periudhën Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhë kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh/vit, me kërkesë të AK.

Çdo cikël trajtimi në habitatet e mësipërme të përfundojë brenda 48 orëve nga data e fillimit, për të shmangur daljen në fluturim të adulateve të llojeve të mushkonjave që zhvillohen në këto habitate. Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës do të përcaktohet nga AK për çdo trajtim.

Vendet potenciale të shumimit të larvave të mushkonjave ku nuk konfirmohet prania e larvave apo të cilat janë të thata nuk duhet të trajtohen.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Në vatrat e përhershme të zhvillimit të larvave, inspektimi para trajtimit duhet të bëhet çdo dy javë. Në vatrat e përkohshme të shumimit të larvave, inspektimi duhet të bëhet brenda 24-48 orëve pas reshjeve, baticës ose përmbytjeve natyrore/artificiale.

Për trajtimin e lagunave, parqeve, kanaleve, pellgjeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën eeb-GIS në kohë reale vendndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën eeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitudo, longitudo) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit. Shërbimi kryhet gjatë orëve të ditës.

✓ **Produktet larvicide që duhet të përdoren**

Shërbimi i dezinfektimit në habitatet e mësipërme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare të vendit tonë janë zona të mbrojtura natyrore nga konventa kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të gjithë kanalet që trajtohen në zonën bregdetare derdhen drejtpërdrejt ose indirekt në det.

Produktet larvicide që duhet të përdoren për trajtimin e habitateve të mësipërme nuk duhet të jenë toksike/të rrezikshme për organizmat ujorë dhe tokësorë jo target dhe nuk duhet të jenë të dëmshëm për njerëzit, kafshët, dhe mjedisin, dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe në etiketë.

Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.)/ose ekuivalent, ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* /ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.

Në vatrat ujore që janë të mbuluara me shumë bimësi depërtimi i formulimeve lëng mund të pengohet nga bimësia. Në këto kushte, të përdoret formulim në gjendje të thatë (ose Granula), i cili depërton bimësinë duke arritur deri në vatrën ujore.

Në vatrat ku është e vështirë të kryhet trajtimi nga toka, mund të kryhen aplikime nga ajri.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid biocid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin, organizmat ujorë e tokësorë jo target dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara, duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg".

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

Trajtimet kryhen në periudhën nga Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhë kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh, me kërkesë të AK.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës përcaktohet nga AK.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë, kryhet një herë në muaj, sipas zonave të përcaktuara nga AK.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë të përfundojë brenda një periudhe 2-3 ditore nga momenti i fillimit të trajtimit (vetëm në rast se përcaktohet ndryshe nga AK).

- Gjatë trajtimit të pusetave OE duhet të mbajë aparatën GPRS vazhdimisht të ndezura dhe në gjendje funksionale gjatë kryerjes së shërbimit për transmetimin në platformën eeb-GIS të dhënave (apicall) që gjenerohen, lidhur me vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik latitude, longitude) gjatë realizimit të shërbimit.
OE është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave të gjeoreferencuara dhe përshtatjen e tyre për ngarkimin në strukturën e të dhënave të standardizuara në platformën eeb-GIS.
- Për trajtimin e bodrumeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën eeb-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën eeb-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Efekti i pritshëm i shërbimit në bodrume dhe puseta me ujë duhet të jetë jo më pak se katër javë.

✓ Produktet larvicide që duhet të përdoren

Bazuar në sa më sipër për trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet të përdoren produkte larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*/ ose ekuivalent ose barriera fizike njëstresore/ose ekuivalent me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën katër javësh në habitatet specifike. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe/ ose në etiketë, dhe ose katalogun përkatës.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të rritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg".

Të tjera

OE është përgjegjës për sigurinë e punonjësve të tij dhe sigurimin e veshjeve personale mbrojtëse për realizimin e shërbimit.

OE është përgjegjës për çdo dëmtim të mjedisit dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi.

Punonjësit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi dhe të përdorin veshje të dukshme me tregues të qartë të emrit dhe ose logos së kompanisë.

Është përgjegjësi e OE sigurimi dhe paraqitja e dokumentacionit që provon kapacitetet e tij teknike lidhur me pajisjet që do të përdorë për realizimin e trajtimeve, metodologjinë e trajtimit, produktin larvicid që do të përdor, duke i listuar dhe përshkruar specifikimet teknike të përdorimit të tyre sipas habitateve të pritshme për trajtim dhe produkteve larvicide/biocide me të cilat parashikon të kryej trajtimin.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim kërkesën e mësipërme për kualifikim lidhur me paraqitjen e autorizimit për produktet biocide si dhe specifikimet teknike përkatëse konstaton se ky dokument është kërkuar konkretisht për produktet larvacide që duhet të përdoren si *produkte larvicide me lëndë vepruese Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.)/ose ekuivalent, ose Bacillus thuringensis israeliensis (B.t.i.) i kombinuar me Bacillus sphaericus /ose ekuivalent, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.* Në këtë kontekst, së pari, KSHA gjykon të ndalet në një interpretim teknik:

Produktet biocide janë përzierje substancash që përdoren për të kontrolluar, penguar ose asgjësuar mikroorganizma të dëmshëm, si bakteret, viruset, kërpudhat, insektet apo brejtësit. Në Europë, përdorimi dhe miratimi i tyre rregullohet nga Rregullorja (EU) Nr. 528/2012, e njohur si Biocidal Products Regulation (BPR).

Në Shqipëri, produktet biocide vlerësohen dhe autorizohen për tu vendosur në treg bazuar në VKM Nr. 933, datë 25.11.2020 *“Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.*

Referuar kuadrit ligjor të sipër cituar, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, citon se kërkesa që Operatori ekonomik ofertues të paraqesë AKT-Autorizimin e produktit biocid, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për produktet larvicide me lëndë vepruese Bacillus thuringiensis israelensis (B.t.i.) ose ekuivalent, apo B.t.i. të kombinuar me Bacillus sphaericus ose ekuivalent, është një kërkesë plotësisht e justifikuar nga pikëpamja teknike dhe funksionale e natyrës së shërbimit. Këto produkte janë biocide të destinuara për kontrollin e larvave të insekteve (kryesisht mushkonjave) në habitate specifike. Edhe pse B.t.i. dhe Bacillus sphaericus janë mikroorganizma me profil relativisht të sigurtë krahasuar me insekticidet kimike tradicionale, ato përsëri mbeten produkte me veprim biologjik aktiv mbi organizma të gjallë. Për këtë arsye, përdorimi i tyre kërkon vlerësim të kontrolluar mbi pastërtinë dhe stabilitetin e formulimit, përqendrimin real të lëndës vepruese, mungesën e ndotësve apo nënprodukteve të dëmshme dhe ndikimin në organizmat jo-target (peshq, amfibë, mikrofaunë ujore etj.)

Referuar Shtojcës 6 të dokumenteve të tenderit, Specifikimet teknike, ndodhur në kushtet ku shërbimi është parashikuar të realizohet në dy habitate të ndryshme, konkretisht në habitate ujore të hapura dhe në puseta/bodrome (ambiente të mbyllura, shpesh me lagështi të lartë dhe ujë të ndenjtur), kërkesa për paraqitjen e AKT-Autorizimit të produktit biocid bëhet edhe më e domosdoshme dhe teknikisht e justifikuar. Autorizimi është akt administrativ individual për produktet biocide. Duke qenë se përdorimi i produkteve biocide pa autorizim është i ndaluar me ligj, AK ka detyrimin të sigurojë që Operatorët ekonomikë pjesmarrës të kenë në dispozicion produkte të autorizuara përpara lidhjes së kontratës. Ky autorizim është ngushtësisht i lidhur me produktin dhe mbajtësin e autorizimit, dhe nuk është një dokument formal që mund të zëvendësohet me deklarime. Përdorimi i një produkti biocid pa autorizim përbën shkelje administrative dhe rrjedhimisht penale. Në rregulloren Europiane 528/2012 (BPR), theksohet që

çdo produkt biocid duhet të jetë i autorizuar përpara vendosjes në treg dhe përdorimit. Pra, kërkesa nuk është kufizuese, por është detyrim ligjor për përdorim të ligjshëm të produkteve biocide. Dezinsektimi i zonave bregdetare ka specifika sensitive sikurse janë afërsia me detin, prania e turistëve dhe komunitetit si dhe mundësia e kontaminimit të ujërave dhe produktet biocide mund të jenë toksike për organizmat ujorë, mund të kenë ndikim në shëndetin publik nëse përdoren jashtë kushteve të autorizimit, ndaj kërkesa e AK për akt autorizimin garanton se produkti është i vlerësuar në Shqipëri, ka kushte të detajuara përdorimi si dhe ka klasifikim dhe masa sigurie të përcaktuara.

Së pari, habitatet ujore të hapura (kanale, pellgje, zona me ujë të ndenjtur apo me rrjedhje të ngadaltë) paraqesin një ekosistem kompleks ku produkti larvicid duhet të jetë selektiv ndaj larvave target dhe njëkohësisht jo-toksik për organizmat jo-target, si peshqit, amfibët, insektet e dobishme dhe mikroorganizmat e tjerë ujorë. Edhe pse Bacillus thuringiensis israelensis (B.t.i.) dhe kombinimi me Bacillus sphaericus njihen për selektivitetin e tyre biologjik, siguria reale varet nga formulimi konkret, përqendrimi, stabiliteti dhe cilësia e prodhimit. Këto elemente verifikohen vetëm përmes procesit të autorizimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dokument në të cilin dëshmojnë elementë si tipi i formulimit të produktit biocid, frazat e rrezikut dhe parandalimit, tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; insekticid, organizmat target etj

Së dyti, puseta dhe bodrumet përbëjnë habitate të mbyllura urbane, shpesh me ventilim të kufizuar, me prani të vazhdueshme të njerëzve dhe me kontakt të mundshëm me rrjetin e ujërave të zeza. Në këto kushte, produkti duhet të plotësojë kërkesa shtesë teknike si të mos çlirojnë gaze apo nënprodukte të dëmshme në ambiente të mbyllura, të ketë stabilitet në kushte me luhatje temperature dhe prani të lëndëve organike, të mos ndikojë negativisht në sistemet e kanalizimeve apo në mikroflorën e trajtimit biologjik të ujërave. Këto karakteristika nuk mund të verifikohen vetëm me deklarin e pretenduar nga ankimesi, por përmes dokumentacionit zyrtar të autorizimit, i cili bazohet në parametra teknike.

Së treti, kërkesa që produkti të ketë efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje aktiviteti minimalisht 2 javë në habitatet specifike është thelbësore nga pikëpamja operacionale. Në mjediset ujore të hapura, faktorë si rrezatimi UV, reshjet dhe rrjedhja e ujit ndikojnë në degradimin e produktit. Në puseta, prania e ngarkesës së lartë organike mund të ulë efikasitetin biologjik. Vetëm produkte të testuara dhe të regjistruara mund të garantojnë performancë të qëndrueshme në të dyja tipologjitë e mjedisit.

Pra, fakti që shërbimi i kërkuar do të kryhet në dy habitate me karakteristika ekologjike dhe teknike të ndryshme nga njëra tjetra, e përforcon nevojën për kontroll rigoroz mbi produktin biocid që do të përdoret. Në rastin konkret, dokumenti akt autorizimi garanton sigurinë për shëndetin publik dhe mjedisin, siguron efikasitet të provuar në kushte reale përdorimi, shmang përdorimin e produkteve të pasigurta ose joefektive dhe përbën një kriter minimal, proporcional dhe teknikisht të domosdoshëm për realizimin korrekt të shërbimit.

Kërkesa për paraqitjen e Akt autorizimit në fazën e ofertimit nuk synon të kufizojë konkurrencën, por të garantojë që ofertuesit të paraqesin oferta reale dhe të zbatueshme, në përputhje me legjislacionin sektorial në fuqi. AK nuk mund të kualifikojë një OE që në momentin e ofertimit nuk provon se disponon mjetin kryesor ligjor për realizimin e shërbimit.

Në një interpretim ligjor, në mbështetje të kuadrit ligjor në fuqi, konkretisht VKM Nr. 933, datë 25.11.2020 "Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të

procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, Kreu III, “Përmbajtja e dosjes së aplikimit për autorizim” ku citohet se: “ 1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme: a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi; b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; 4 - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid. c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi; ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit. d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla; dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe; e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe. ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”; f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet. g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg; gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide; h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës I, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; i) Faturën e pagesës së aplikimit”, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave gjykon se hapat për pajisjen me dokumentin e kërkuar janë qartësisht përshkruar sa më sipër.

Lidhur me pretendimin konkret të Operatorit ekonomik ankimes se: “Autorizimi për produktin biocid lidhet me vendosjen në treg dhe përdorimin konkret të produktit. Ai është dokument që

garanton se produkti është i sigurt dhe i lejuar për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, në fazën e ofertimit, autoriteti vlerëson kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përvojën e mëparshme, ofertën ekonomike. Vlerësimi i ofertës nuk kërkon domosdoshmërisht që produktet konkrete të jenë tashmë të autorizuar në momentin e hapjes së ofertave, për sa kohë që operatori angazhohet se do të përdorë vetëm produkte të autorizuar dhe i paraqet këto autorizime përpara fillimit të zbatimit të kontratës. Kërkesa aktuale e zhvendos një detyrim që i përket fazës së ekzekutimit në fazën e ofertimit, duke e kthyer atë në kriter eliminues, çka shkon përtej asaj që është e nevojshme për vlerësimin e ofertës”, KSHA gjykon se nuk qëndron si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga ajo ligjore në kuadër të legjislacionit të prokurimit publik. Objekti i procedurave të prokurimit, është një shërbim i cili për shkak të natyrës do të realizohet edhe nëpërmjet përdorimit të produkteve konkrete biocide, me përbërje dhe karakteristika të caktuara (p.sh. B.t.i., B.t.i. + Bacillus sphaericus ose ekuivalent). Cilësia e shërbimit të kërkuar, konkretisht dezinfektimi, lidhur me efikasitetin, kohëzgjatjen e veprimit (minimum 2 javë) dhe sigurinë për organizmat jo target varen drejtpërdrejt nga produkti që do të propozohet në kuadër të procesit të ofertimit. Për rrjedhojë, produkti biocid nuk është element dytësor i fazës së zbatimit, por pjesë thelbësore e ofertës teknike.

Nëse produkti biocid nuk është i autorizuar në momentin e hapjes së ofertave, Autoriteti Kontraktor nuk ka garanci objektive se është i lejuar për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë, përmbush standardet e sigurisë mjedisore dhe shëndetësore, ka efikasitet të provuar në habitatet specifike (ujore dhe puseta/bodrome) si dhe ka kohëzgjatjen minimale të kërkuar të aktivitetit.

Një “angazhim apo deklaram” i përgjithshëm siç pretendohet nga Operatori ekonomik ankimues se do të përdoren produkte të autorizuar në të ardhmen nuk është i mjaftueshëm për të vlerësuar seriozitetin dhe cilësinë e ofertës së paraqitur. Gjithashtu procesi i vlerësimit të kapacitetit teknik nuk kufizohet vetëm në përvojën dhe stafin, por përfshin edhe mjetet dhe burimet konkrete me të cilat do të realizohet kontrata. Produkti biocid është mjete teknik kryesor i realizimit të shërbimit. Në këtë kuptim, autorizimi është provë e disponueshmërisë ligjore dhe teknike të këtij mjeti. Një Operator ekonomik ofertues që nuk ka identifikuar një produkt të autorizuar në momentin e ofertimit paraqet një ofertë të pasigurtë dhe potencialisht të porealizueshme. Autoriteti kontraktor ka detyrimin të sigurohet paraprakisht se produktet që do të përdoren janë të autorizuar dhe të sigurt. Verifikimi pas shpalljes fitues do ta zhvendoste këtë kontroll në një fazë ku procedura ka përfunduar, duke krijuar rrezik për dështim të kontratës ose vonesa. Kërkesa për autorizim në fazën e ofertimit nuk zhvendos detyrime nga faza e zbatimit, por siguron që oferta e paraqitur është e bazuar në produkte realisht të përdorshme dhe të ligjshme. Në të kundërt, do të lejohej paraqitja e ofertave që mbështeten në produkte hipotetike, të paautorizuara ose ende të paregjistruara, duke krijuar pabarazi dhe pasiguri juridike.

Ndërsa lidhur me pretendimin e Operatorit ekonomik ankimues për kundërshtimin e ndalimit të mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera lidhur me dokumentin e kërkuar, akt autorizimi për produktet biocide, KSHA thekson së pari se në varësi të llojit, rëndësisë dhe peshës së kriterit kualifikues, është në diskrecionin e Autoriteti Kontraktor lejimi ose jo i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera. Moslejimi i mbështetjes në subjekt tjetër për këtë kriter është i arsyetuar dhe i argumentuar, pasi Akt autorizimi është akt administrativ individual, i lidhur me subjektin mbajtës të tij dhe përgjegjësinë ligjore për produktin.

Për më tepër, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave citon se një element me rëndësi në vlerësimin e këtij pretendimi është edhe analiza e praktikës administrative dhe e qëndrimeve të mëparshme të vetë Operatorit ekonomik ankimues. Nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se i njëjti Operator

ekonomik ankimues, në një ankesë të mëparshme, protokolluar pranë KPP-së me Nr. Prot. 896/2023 me objekt: *Loti 5 "Shërbim Dezinsektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier"*, ka kërkuar shprehimisht shtimin e kriterit për paraqitjen e autorizimit të produkteve biocide në fazën e ofertimit, duke argumentuar se kjo garanton ligjshmërinë, sigurinë dhe seriozitetin e ofertës. Në atë rast, Operatori ekonomik "NRG" shpk ka mbrojtur pikërisht versionin se mungesa e autorizimit të produkteve biocide (autorizim prodhuesi ose leje importi konvertuar në autorizim për produktet biocide), në momentin e hapjes së ofertave cënon përmbushjen e specifikimeve teknike si dhe vetë barazinë në konkurrim.

Ndërsa në procedurën aktuale, të ndarë në lote, objekt ankimimi, i njëjti Operator ekonomik kundërshton të njëjtin kriter, duke pretenduar ndër të tjera, se autorizimi duhet të kërkohe vetëm në fazën e zbatimit të kontratës.

Kjo mospërputhje në qëndrime tregon qartë se kundërshtimi aktual nuk bazohet në një analizë të qëndrueshme ligjore apo teknike, por në një tendencë oportuniste të lidhur me interesin konkret aktual. Parimet e barazisë, sigurisë juridike dhe koherencës kërkojnë që subjektet pjesëmarrëse në procedurat e prokurimit të mbajnë qëndrime të qëndrueshme dhe të mos adoptojnë interpretime kontradiktore sipas interesave aktualë. Nga pikëpamja e praktikës administrative, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave vlerëson jo vetëm pretendimet përkundrejt kërkesave për kualifikim dhe dispozitave ligjore, por edhe konsistencën e argumenteve të ankimuesve lidhur me këto pretendime. Kur një Operator ekonomik akimues ka mbështetur më parë domosdoshmërinë e një kriteri si element garantues për sigurinë dhe ligjshmërinë e ofertës, dhe më pas e kundërshton të njëjtin kriter në rrethana të ngjashme, kjo ul ndjeshëm besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë e pretendimit aktual.

Për më tepër, fakti që nga analiza e praktikave administrative të mëparshme është arritur në përfundimin se kërkesa për autorizimin për produktet biocide në fazën e ofertimit është e arsyeshme dhe në përputhje me objektin e kontratës, përforcon legjitimitetin e vendosjes së këtij kriteri edhe në procedurën konkrete, të ndarë në lote, objekt ankimimi.

Në analizën e pretendimit të paraqitur nga Operatori ekonomik ankimues lidhur me kriterin e paraqitjes së AKT-Autorizimit për produktet biocide në fazën e ofertimit, KSHA thekson se një element thelbësor që nuk mund të anashkalohet është shqyrtimi i praktikës administrative dhe situatës faktike të vetë ankimuesit. Nga verifikimi i praktikave administrative dhe procedurave të mëparshme të ngjashme, rezulton se i njëjti Operator ekonomik zotëron autorizime të vlefshme për produkte biocide dhe, për më tepër, është aktualisht duke realizuar kontrata të ngjashme që kërkojnë përdorimin e produkteve biocide të autorizuara.

Ky fakt dëshmon se kërkesa për paraqitjen e autorizimit për produktet biocide në fazën e ofertimit nuk përbën pengesë reale apo disproporcionale për Operatorin ekonomik ankimues. Nëse ky subjekt disponon tashmë autorizime dhe i përdor ato në kontrata të tjera publike, atëherë paraqitja e tyre në një procedurë tjetër të ngjashme nuk krijon barrë shtesë objektive. Për rrjedhojë, pretendimi se kriteri është i tepruar, eliminues apo kufizues i konkurrencës nuk gjen mbështetje në situatën konkrete të ankimuesit dhe ky fakt e bën pretendimin më tepër teorik sesa të bazuar në një cenim real.

Për sa më sipër, pretendimi i Operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në Nenin 114 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), dhe Nenit 102 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), Komisioni i ngarkuar për Shqyrtimin e Ankesave,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga Operatori ekonomik "NRG" shpk.
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.

II.6. Operatori ekonomik "NRG" SHPK ka paraqitur në KPP argumente shtesë për ankesat me nr A/2026/6351/, A/2026/6362, A/2026/6353, A/2026/6354, A/2026/6355 protokolluar me tonën me nr.546/3 prot., datë 27.02.2026 përmbajtje si vijon:

Siç dihet Operatori i Blerjeve të Përqendruar ka publikuar dokumentet e tenderit për procedurën me objekt "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane", ndarë në 5 lote (Shkodër, Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë), lidhur me të cilat kemi paraqitur ankim me datë 20.02.2026 duke arsyetuar e detajuar shkaqet.

Në vijim të këtij ankimi, çmujmë të domosdoshme të evidentojmë në mënyrë më të hollësishme një sërë argumentash lidhur me shkaqet e parashtruara në ankim që tregojnë mospërputhshmëritë e forta të DST, të cilat jo vetëm që nuk garantojnë zhvillim të procesit të prokurimit sipas kërkesave ligjore, por në fakt venë haptazi në dyshim integritetin e këtij procesi.

I. Në lidhje me kriterin ekonomik:

Në Dokumentet Standarde të Tenderit janë përcaktuar në mënyrë të detajuar kriteret kualifikuese për çdo lot. Veçanërisht, në **Lotin 1: "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër"**, në pikën 2 "Kriteret e veçanta të prokurimit", nën pikën **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar**, është parashikuar si më poshtë:

"2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit të lotit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën një (1) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare."

Në këtë pikë është përcaktuar vetëm xhironja vjetore si kriter i vetëm kualifikues, për sa i përket vërtetimit nga operatori ekonomik të kapacitetit ekonomik dhe financiar me qëllim përmbushjen e objektit të kontratës.

Ndërsa, në lotet e tjera të së njëjtës procedurë, konkretisht:

- **Loti 2:** "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Tiranë"
- **Loti 3:** "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës"
- **Loti 4:** "Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Fier"

- **Loti 5:** “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Vlorë”

për sa i përket kriterit ekonomik dhe financiar, është përcaktuar:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të lotit.*

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 *Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Standardet e dyfishta të aplikuara në DST ndërmjet Lotit 1 dhe loteve të tjera nuk janë thjesht dallime teknike, por devijime substanciale dhe ky diferencim përbën një nga problematikat e DST.

Për Lotin 1 “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”:

Kërkohe xhiro minimale vetëm 40% e fondit limit, e realizuar në të paktën një nga vitet 2022-2024;

Nuk kërkohet paraqitja e bilanceve vjetore të shoqëruara me akt-ekspertizë kontabël;

Nuk kërkohet verifikimi i raportit aktiv-pasiv;

Kërkohe eksperiencë e mëparshme në masën 20% të fondit limit.

Për Lotet 2, 3, 4 dhe 5 (Tiranë, Durrës, Fier, Vlorë):

Kërkohe xhiro minimale në masën 100% të fondit limit, e realizuar në të paktën një nga vitet 2022-2024;

Kërkohe paraqitja e bilanceve trevjeçare të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar;

Kërkohe që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos ketë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit;

Kërkohe eksperiencë e mëparshme në masën 40% të fondit limit.

Diferencimi i theksuar i kriterëve ekonomike dhe financiare ndërmjet Lotit 1 dhe loteve 2, 3, 4 dhe 5, pavarësisht se të gjitha kanë si objekt të njëjtin shërbim, dezinfektimin e zonave urbane dhe bregdetare, përbën një devijim të pajustificuar nga parimet themelore të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në veçanti nga parimi i proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe garantimit të konkurrencës efektive. Kërkesa që për Lotin 1 të mjaftojë një xhiro minimale në masën 40% të fondit limit dhe një eksperiencë në masën 20%, ndërkohë që për lotet e tjera kërkohet xhiro në masën 100% të fondit limit, eksperiencë 40%, si dhe dokumentacion financiar shumë më i detajuar, përfshirë bilance të certifikuara nga ekspert kontabël dhe analiza të raportit aktiv pasiv, nuk reflekton një dallim objektiv në natyrën apo kompleksitetin e shërbimit, por krijon standarde të ndryshme kualifikimi për të njëjtin lloj kontrate. Në kushtet kur shërbimi i dezinfektimit realizohet mbi të njëjtat metoda teknike, me të njëjtat pajisje dhe produkte biocide dhe mbi bazën e të njëjtave kërkesa ligjore dhe sanitare, vendosja e pragjeve të ndryshme financiare nuk rezulton e mbështetur në ndonjë analizë të dokumentuar të riskut, kompleksitetit apo volumit teknik që do të justifikonte një trajtim të diferencuar.

Ky diferencim merr rëndësi edhe më të madhe për faktin se është vendosur nga i njëjti autoritet kontraktor, brenda së njëjtës procedurë prokurimi dhe në të njëjtën kohë, çka përjashton çdo mundësi justifikimi mbi bazën e ndryshimit të praktikave institucionale apo evoluimit të standardeve në kohë. Në këto kushte, aplikimi i pragjeve të ndryshme financiare dhe ekonomike krijon një trajtim të pabarabartë të operatorëve ekonomikë në varësi të lotit për të cilin ata konkurrojnë dhe cenon parimin e neutralitetit të procedurës. Në aspekt praktik, kjo situatë krijon një paradoks procedural, pasi një operator ekonomik që konsiderohet i kualifikuar për të realizuar shërbimin në Lotin 1, sipas standardit të vendosur nga vetë autoriteti kontraktor, mund të konsiderohet automatikisht i pakualifikuar për lote të tjera që kanë të njëjtën natyrë shërbimi, vetëm për shkak të vendosjes artificiale të pragjeve më të larta financiare, pa një justifikim objektiv teknik apo operacional.

Për më tepër, vendosja e kërkesave shtesë vetëm për disa lote, si paraqitja e bilanceve të certifikuara dhe verifikimi i raportit aktiv pasiv, përbën një shtim selektiv të filtrave financiarë që nuk lidhet drejtpërdrejt me aftësinë reale për të realizuar shërbimin, por krijon një pengesë administrative dhe financiare që kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në mënyrë të pabarabartë. Në mungesë të një arsytimi teknik dhe ekonomik të dokumentuar që të provojë se realizimi i shërbimit në këto lote kërkon një nivel ndjeshëm më të lartë stabiliteti financiar se ai i kërkuar për Lotin 1, ky diferencim përbën një kufizim të pajustificuar të konkurrencës

dhe bie ndesh me nenin 77 të ligjit nr. 162 2020, i cili kërkon që kriteret të jenë proporcionale dhe të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës.

Në këto rrethana, diferencimi ekstrem i pragjeve të kualifikimit, nga 40% në 100% për xhiron minimale dhe nga 20% në 40% për eksperiencën e mëparshme, i kombinuar me vendosjen selektive të kërkesave shtesë financiare vetëm për disa lote, krijon një dyshim të arsyeshëm mbi objektivitetin e hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit dhe cenon besimin legjitim të operatorëve ekonomikë në ekzistencën e një gare reale, të hapur dhe të paanshme. Një strukturë e tillë kriteresh, në mungesë të një justifikimi të qartë teknik dhe ekonomik, krijon premisa për deformimin e konkurrencës dhe bie në kundërshtim me qëllimin e legjislacionit të prokurimit publik për të garantuar përdorimin efikas të fondeve publike dhe pjesëmarrjen sa më të gjerë të operatorëve ekonomikë të kualifikuar.

Në këto lote, konstatohet se Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se kushti për përmbushjen e kriterit ekonomik dhe financiar nuk është vetëm xhiroja e tre viteve të fundit, por ka vendosur edhe kriterin shtesë të paraqitjes së bilanceve vjetore për tre vitet e fundit, të shoqëruara me akt ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar.

Sa më sipër, mbështetur në bazën ligjore si më poshtë, parashtrojmë:

Në nenin 2 të ligjit nr. 162 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”*

Vendosja selektive e kriterëve për lote të ndryshme të së njëjtës procedurë bie ndesh me këto qëllime të parashikuara shprehimisht në ligj.

Në nenin 3 të ligjit nr. 162 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë dhe në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventave ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

Mungesa e kriterit për Lotin 1 favorizon operatorë që nuk përmbushin standardin ekonomik-financiar të kërkuar për lotet e tjera, duke cenuar në këtë mënyrë parimet themelore të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik.

Në nenin 21 të ligjit nr. 162 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike dhe nevojat e tij, si dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

Mungesa e arsytimit objektiv për diferencimin e Lotit 1 përbën shkelje të këtij detyrimi ligjor.

Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit nr. 162 2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Objekti i të gjitha loteve është homogjen në natyrë: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, i ndarë sipas qarqeve administrative. Nuk kemi të bëjmë me shërbime të një natyre të ndryshme, me profile teknike apo risk operacional të ndryshëm, por me të njëjtin lloj shërbimi, të zbatuar në territore të ndryshme. Diferenca qëndron vetëm në shtrirjen gjeografike dhe në vlerën e fondit limit, jo në kompleksitetin teknik të shërbimit. Për pasojë, çdo dallim në metodologjinë e verifikimit të kapacitetit ekonomik duhet të jetë i arsytuar mbi bazë objektive dhe të dokumentuar, çka në rastin konkret mungon.

Kriteri i paraqitjes së bilanceve të shoqëruara me akt ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar nuk është kriter që lidhet me madhësinë absolute të fondit limit, por me stabilitetin

financiar dhe strukturën e shëndetit ekonomik të operatorit. Ky është një instrument kontrolli mbi raportin aktiv pasiv dhe mbi qëndrueshmërinë financiare të subjektit. Në këtë kuptim, ose ky instrument konsiderohet i domosdoshëm për të garantuar zbatimin e kontratës, ose nuk konsiderohet i tillë. Nuk mund të pranohet që e njëjta kontratë shërbimi, me të njëjtin risk profesional dhe me të njëjtat detyrime ligjore për mbrojtjen e shëndetit publik, të kërkojë kontroll të thelluar financiar në një lot dhe jo në një tjetër, pa një arsyetim teknik specifik.

Është e pranueshme që vlera minimale e xhiros të lidhet proporcionalisht me fondin limit të çdo loti. Megjithatë, metodologjia e verifikimit të kapacitetit ekonomik duhet të jetë koherente brenda së njëjtës procedurë. Ndryshimi i metodologjisë duke kërkuar në disa lote vetëm xhiro dhe në të tjera xhiro plus analizë bilanci, krijon standarde të ndryshme pranueshmërie për operatorë që marrin pjesë në të njëjtin proces prokurimi. Kjo cenon jo vetëm parimin e trajtimit të barabartë sipas nenit 3 të ligjit nr. 162/2020, por edhe parimin e sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë së vendimmarrjes administrative.

Mungesa e kriterit të bilancit në Lotin 1 krijon një situatë objektivisht të pabarabartë ndërmjet operatorëve që ofertojnë vetëm në Lotin 1 dhe atyre që ofertojnë në lotet e tjera. Operatorët që marrin pjesë në Lotet 2 - 5 i nënshtrohen një kontrolli më të thelluar financiar, ndërsa operatorët që marrin pjesë vetëm në Lotin 1 i shmangen këtij kontrolli, pavarësisht se natyra e detyrimeve kontraktore mbetet e njëjtë. Kjo krijon një standard të dyfishtë brenda së njëjtës procedurë, pa një bazë të qartë ligjore apo teknike.

Në kuptim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, kërkesat për kualifikim duhet të jenë të lidhura dhe proporcionale me objektin e kontratës. Lidhja me objektin nënkupton jo vetëm raportin me vlerën monetare, por edhe me riskun dhe përgjegjësinë që rrjedh nga ekzekutimi i kontratës. Shërbimi i dezinfektimit përfshin përdorimin e produkteve biocide dhe ndërhyrje me ndikim në shëndetin publik, çka kërkon një nivel të caktuar stabiliteti financiar për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit gjatë 24 muajve të marrëveshjes kuadër. Nëse ky stabilitet konsiderohet i domosdoshëm për lotet me vlerë më të lartë, ai nuk mund të konsiderohet i panevojshëm për lotet me vlerë më të ulët, për sa kohë kohëzgjatja dhe natyra e detyrimeve mbeten identike.

Në mungesë të një arsyetimi të dokumentuar nga autoriteti kontraktor që të justifikojë diferencimin metodologjik, ky diferencim rezulton arbitrar. Vendimmarrja administrative në fushën e prokurimit publik duhet të jetë e motivuar, e arsyetuar dhe e bazuar në kriteret objektive. Çdo dallim në trajtimin e loteve brenda së njëjtës procedurë kërkon një justifikim të qartë teknik dhe financiar, i cili në dokumentet e tenderit nuk rezulton të jetë i shprehur.

6

Për këto arsye, **diferencimi metodologjik i kriterëve ekonomike ndërmjet Lotit 1 dhe loteve të tjera, në mungesë të një arsytimi objektiv dhe të dokumentuar, cenon parimin e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe transparencës, të sanksionuara në nenet 2, 3 dhe 77 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, dhe përbën shkak të mjaftueshëm për modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit në drejtim të unifikimit të standardit të verifikimit të kapacitetit ekonomik.**

Sa më sipër, vendosja e kriterëve nga autoritetet kontraktore duhet të jetë koherente, e arsytuar dhe e njëjtë për raste të njëjta.

Për këto arsye, kërkojmë modifikimin e Dokumenteve Standarde të Tenderit, duke e shtuar edhe në Lotin 1 kërkesën:

“2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), të shoqëruara me Akt Ekspertize të Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.”

2. Në lidhje me kriterin teknik:

“2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.”

E vleresojmë si një kriter diskriminues dhe kufizues argumentuar si më poshtë:

Duke qenë se procedura për autorizimin e produkteve biocide parashikon afate të zgjata administrative për shqyrtimin dhe miratimin e dosjes, ajo objektivist nuk përputhen me afatet e zakonshme të procedurave të prokurimit publik. Për pasojë, operatorët ekonomikë nuk kanë mundësi reale të pajisen me autorizimin brenda një periudhe kaq të shkurtër. Kjo do të thotë se autorizimi nuk është një dokument që merret menjëherë apo brenda një afati të shkurtër, por është rezultat i një procesi administrativ dhe teknik që përfshin shqyrtim formal dhe vlerësim shkencor të dosjes. Vlerësimi i dosjes bëhet në bazë të dokumentacionit të përcaktuar.

Në Kreun 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së

autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, parashikohet shprehimisht se: 1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme:

a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi;

b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid.

c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi;

ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit.

d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla;

dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95 2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuara. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe;

e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën 1(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënat që provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”;

f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet.

g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg;

gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide;

h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkruar të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;

i) Faturën e pagesës së aplikimit.

Ndërkohë, procedurat e prokurimit publik zakonisht parashikojnë afate shumë më të shkurtra për dorëzimin e ofertave. Vendosja e detyrimit që operatori ekonomik të paraqesë autorizimin për të gjitha produktet biocide që në momentin e hapjes së ofertave krijon një barrë administrative që mund të zgjasë përtej afatit kohor të procedurave tenderuese, përpara se operatori të dijë nëse do të shpallet fitues.

Kjo krijon një disproporcion të qartë ndërmjet barrës që i ngarkohet operatorit ekonomik në fazën e ofertimit dhe nevojës reale të Autoritetit Kontraktor për të garantuar sigurinë e shërbimit. Kërkesa që operatori ekonomik duhet të paraqesë “AKT Autorizimin e produktit Biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave”, në thelb e trajton autorizimin si një atribut të operatorit ekonomik, ndërkohë që, sipas Ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” dhe VKM nr. 933/2020, autorizimi është atribut i produktit biocid dhe jo i subjektit që e përdor atë në kuadër të një shërbimi.

Legjislacioni sektorial i cituar më sipër parashikon se autorizimi jepet për produktin, pas një procesi vlerësimi teknik dhe shkencor mbi përbërjen, efektivitetin dhe sigurinë e tij. Autorizimi lidhet me vendosjen në treg të produktit dhe me përdorimin e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, por nuk kushtëzon që çdo operator që e përdor produktin në kuadër të një kontrate shërbimi të jetë vetë mbajtës i autorizimit. Në praktikë, autorizimi mund të jetë në emër të prodhuesit, importuesit apo distributorit të produktit, ndërsa operatori i shërbimit është përdorues i produktit të autorizuar.

Në këtë kuptim, kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë autorizimin si kriter kualifikimi në fazën e ofertimit, pa lejuar mbështetjen në kapacitetet e subjekteve të tjera, krijon një kufizim strukturor të konkurrencës. Ajo favorizon subjektet që janë njëkohësisht importues ose mbajtës të autorizimit, duke përjashtuar operatorë të tjerë që mund të kenë kapacitete të plota teknike dhe profesionale për kryerjen e shërbimit, por që furnizohen me produkte biocide të autorizuara nga subjekte të tjera.

Kjo qasje nuk është në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar në nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, sipas të cilit autoritetet kontraktore duhet të veprojnë në mënyrë proporcionale dhe të mos kufizojnë artificialisht konkurrencën. Nëse qëllimi legjitim i autoritetit kontraktor është garantimi që në ekzekutimin e kontratës do të përdoren vetëm produkte biocide të autorizuara, ky qëllim mund të arrihet përmes mjeteve më pak kufizuese, siç është kërkimi që autorizimi i produktit të paraqitet para nënshkrimit të kontratës ose para fillimit të zbatimit të saj.

Ndalimi absolut i mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për këtë kriter, i parashikuar në Dokumentet e Tenderit, përbën një kufizim të pajustificuar të një instrumenti të njohur shprehimisht nga ligji i prokurimit publik. Për sa kohë që autorizimi i produktit nuk është atribut personal i operatorit, por i vetë produktit, ndalimi i mbështetjes në kapacitete të treta nuk justifikohet si “aspekt kritik i kontratës” në kuptimin e nenit 78 të LPP, përveçse nëse provohet se përdorimi i produktit kërkon kontroll të drejtpërdrejtë juridik mbi autorizimin, gjë që nuk rezulton nga legjislacioni sektorial.

Për më tepër, vendosja e këtij kriteri në momentin e hapjes së ofertave, si kusht kualifikues, e zhvendos fokusin nga aftësia reale për të ekzekutuar kontratën në një element formal, i cili mund të sigurohet edhe në fazën e kontraktimit. Prokurimi publik synon të identifikojë operatorin ekonomik më të përshtatshëm për të realizuar shërbimin, jo të kufizojë pjesëmarrjen për arsye që mund të zgjidhen në mënyrë proporcionale gjatë fazës së ekzekutimit.

Në këtë kuadër, kërkesa aktuale përbën një kriter teknik që shkon përtej asaj që është e domosdoshme për garantimin e zbatimit të kontratës dhe bie në kundërshtim me parimet e

10

konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe proporcionalitetit. Për rrjedhojë, ajo duhet të modifikohet në mënyrë që të kërkojë përdorimin e produkteve të autorizuara, pa e kushtëzuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë me faktin që autorizimi të jetë në emrin e tyre dhe pa ndaluar mbështetjen në kapacitete të subjekteve të tjera.

Autorizimi është dokument i lidhur me fazën e ekzekutimit, jo me vlerësimin e ofertës, kjo e përcaktuar shumë qartë në nenin 8 te Ligjit nr. 95 2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”

Neni 8

Autorizimi për bërjen të disponueshme për treg të produkteve biocide

1. Të gjitha lëndët vepruese dhe produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, bëhen të disponueshme për treg pas pajisjes me autorizim nga autoriteti kompetent.

2. Autoriteti kompetent autorizon produktet biocide, duke lejuar bërjen të disponueshme për treg në territorin e Republikës së Shqipërisë, pas paraqitjes së dokumentacionit nga personi fizik ose juridik dhe verifikimit nëse dosja i përmbush kërkesat, sipas këtij ligji.

3. Ministri përgjegjës për shëndetësinë, për raste të gjendjeve të emergjencës shëndetësore apo emergjencës civile, kur luftimi i një agjenti biologjik të dëmshëm gjykohet se nuk realizohet me produktet biocide të autorizuara, autorizon importimin dhe përdorimin e kufizuar të produkteve biocide të paautorizuara përmes procesit normal të bërjes së disponueshme për treg. Autorizimi është i vlefshëm për një periudhë deri në 4 muaj dhe për një sasi të argumentuar nga Instituti i Shëndetit Publik, sipas emergjencës.

4. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

a) produkte biocide të prodhuara në vend;

b) produkte biocide të autorizuara në njërin nga vendet e Bashkimit Europian, në Zvicër, SHBA, Kanada, Japoni, Turqi, Izrael dhe Australi;

c) produktet biocide të prodhuara dhe të autorizuara në vendet e Ballkanit.

5. Rregullat për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedurën e dhënies së autorizimit të vendosjes në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Autorizimi për produktin biocid lidhet me vendosjen në treg dhe përdorimin konkret të produktit. Ai është dokument që garanton se produkti është i sigurt dhe i lejuar për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Megjithatë, në fazën e ofertimit, autoriteti vlerëson kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përvojën e mëparshme, ofertën ekonomike.

Vlerësimi i ofertës nuk kërkon domosdoshmërisht që produktet konkrete të jenë tashmë të autorizuar në momentin e hapjes së ofertave, për sa kohë që operatori angazhohet se do të përdorë vetëm produkte të autorizuar dhe i paraqet këto autorizime përpara fillimit të zbatimit të kontratës.

Kërkesa aktuale e zhvendos një detyrim që i përket fazës së ekzekutimit në fazën e ofertimit, duke e kthyer atë në kriter eliminues, çka shkon përtej asaj që është e nevojshme për vlerësimin e ofertës.

Autoriteti kontraktor në këtë mënyrë ngushton rrethin e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në kundërshtim me nenin 3 dhe nenin 77 të Ligjit nr. 162 2020 "Për Prokurimin Publik". Kjo sjell kufizim të konkurrencës dhe ulje të numrit të operatorëve pjesëmarrës, pa qenë e domosdoshme për garantimin e interesit publik.

Në vijim të argumentimit të paraqitur lidhur me kërkesën për paraqitjen e AKT Autorizimit të produktit biocid, çmujmë të nevojshme të theksojmë se thelbi i problematikës në rastin konkret nuk qëndron vetëm në ekzistencën e autorizimit si dokument formal, por në mënyrën se si është konceptuar dhe përdorur kërkesa për Autorizim Importi në raport me historikun e kësaj procedure dhe me misionin teknik të vetë shërbimit të kërkuar.

Duhet theksuar se autorizimi i importit, sipas legjislacionit për produktet biocide, është një akt administrativ që lidhet me hyrjen në territor të një produkti të caktuar dhe me kontrollin e dokumentacionit teknik që shoqëron produktin. Ky autorizim nuk është garanci në vetvete për përshtatshmërinë e produktit ndaj organizmave target të kërkuar në Dokumentet Standarde të Tenderit. Përkundrazi, përmbajtja teknike e autorizimit varet nga dokumentacioni i paraqitur nga aplikuesi dhe nga vlerësimi formal-administrativ i kryer nga autoriteti kompetent.

Precedenti i procedurës së vitit 2023 për shërbimin e dezinfektimit tregon qartazi se Autorizimi i Importit është përdorur për të "mbuluar" përdorimin e një produkti (Aquabac), i cili nuk rezultonte i përshtatshëm për organizmat target të kërkuar në DST. Pra, ekzistenca e autorizimit nuk garanton përputhshmërinë reale teknike të produktit me kërkesat e tenderit. Përkundrazi, ai u përdor si instrument formal për të legjitimuar përdorimin e një produkti që, në substancë, nuk përmbushte misionin teknik të ndërhyrjes.

Ky precedent është thelbësor në analizën e proporcionalitetit të kriterit aktual. Nëse autorizimi i importit nuk garanton automatikisht përputhshmërinë teknike të produktit me organizmat target, atëherë kërkesa për paraqitjen e tij si kriter kualifikimi nuk është mjet i përshtatshëm për arritjen e qëllimit legjitim (mbrojtja e shëndetit publik dhe efektiviteti i ndërhyrjes). Një kriter që nuk është i përshtatshëm për arritjen e qëllimit të deklaruar bie ndesh me testin e proporcionalitetit.

}

Ndryshimi i DST-së në këtë mënyrë nuk është thjesht një riformulim teknik, por përbën një devijim substancial nga kërkesat reale të misionit të ndërhyrjes dhe nga kuadri ligjor i produkteve biocide. Heqja ose relativizimi i elementeve thelbësore që lidhen me organizmat target, me tipologjinë e formulimit dhe me përputhshmërinë me përdorimin në zona bregdetare krijon një hapësirë të pajustificuar për interpretim, duke mundësuar që një produkt si Aquabac e etj, të paraqitet si i përshtatshëm, edhe pse në përmbajtje nuk përmbush kërkesat specifike të kontrollit të organizmave të dëmshëm të përcaktuar në DST.

Në kuptim të nenit 8 të ligjit nr. 95 2015, autorizimi i produktit biocid është i lidhur ngushtësisht me përshkrimin e saktë të përdorimit, me organizmat target dhe me dozimin e aplikimit. Pra, autorizimi nuk është një dokument abstrakt, por një akt që mbështetet mbi parametra teknikë konkretë. Nëse DST modifikohet në mënyrë që të mos kërkojë përputhje të qartë midis organizmave target të përcaktuar në dosjen e autorizimit dhe atyre të kërkuar në tender, atëherë krijohet një shkëputje artificiale midis autorizimit formal dhe efektivitetit real biologjik të produktit.

Autorizimi i produktit biocid jepet mbi bazën e një dosjeje që përmban përdorimin e deklaruar, organizmat target të specifikuar dhe dozat e aplikimit. Pra, autorizimi është i kushtëzuar nga një fushë përdorimi e caktuar. Nëse DST nuk kërkon përputhje eksplicite midis organizmave target të autorizimit dhe organizmave target të tenderit, atëherë **autorizimi mbetet një dokument formal që provon se produkti është “i lejuar për treg”, por jo domosdoshmërisht se është i autorizuar për atë përdorim konkret.**

Autorizimi vlerëson sigurinë dhe efektivitetin në raport me parametrat e paraqitur nga aplikuesi. Nëse produkti është autorizuar për një spektër të caktuar organizmash (p.sh. larva të caktuara në kushte të kontrolluara), por tenderi kërkon ndërhyrje ndaj organizmave të tjerë ose në kushte specifike (zona bregdetare, ekspozim ndaj kripës, temperatura të larta, dinamika të veçanta ekologjike), atëherë mungesa e kërkesës për përputhje direkte krijon një boshllëk teknik. **Produkti mund të jetë i autorizuar, por jo i testuar dhe i provuar për situatën konkrete.**

Nëse DST kërkon vetëm “AKT Autorizimin” pa kërkuar që përmbledhja e karakteristikave të produktit të përfshijë saktësisht organizmat target të tenderit, atëherë verifikimi i autoritetit kontraktor mbetet sipërfaqësor. Autoriteti kontrollon ekzistencën e autorizimit, por jo përmbajtjen teknike të tij. Kështu krijohet ajo që në analizë juridike konsiderohet “shkëputje midis formës dhe substancës”: forma (autorizimi ekziston) plotësohet, por substanca (efektiviteti real për objektin e kontratës) nuk provohet. Kjo situatë krijohet shpesh kur kriteri

13

teknik është konceptuar si kriter formal kualifikimi dhe jo si kriter i lidhur drejtpërdrejt me performancën e kontratës. **Autorizimi trajtohet si dokument administrativ që “mbyll” kontrollin ligjor, ndërkohë që ai në vetvete nuk është provë e mjaftueshme për përshtatshmërinë biologjike për një ndërhyrje specifike.**

Në kontekstin e precedentit të vitit 2023, kjo shkëputje ndodh sepse autorizimi i importit u përdor si mburojë formale për të legjitimuar një produkt që, në thelb, nuk përmbushte kërkesat teknike të misionit të ndërhyrjes. Pra, mungesa e lidhjes së detyrueshme midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të DST-së e bëri të mundur që produkti të kalojë filtrin formal të kualifikimit pa provuar efektivitetin real.

Në thelb, kjo ndodh sepse autorizimi provon lejen për treg, por jo domosdoshmërisht përshtatshmërinë për një përdorim specifik, DST, nëse nuk kërkon përputhje të drejtpërdrejtë teknike, redukton kontrollin në verifikim formal, vlerësimi zhvendoset nga analiza e përmbajtjes në kontroll të ekzistencës së dokumentit, duke krijuar mundësinë që një produkt të jetë ligjërish i autorizuar, por teknikisht i papërshtatshëm për objektin konkret të kontratës.

Prandaj, nëse nuk kërkohet përputhje eksplicite midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të përcaktuar në DST, krijohet një hendek midis autorizimit formal dhe efektivitetit real biologjik, që cenon parimin e lidhjes së drejtpërdrejtë të kriterit me objektin e kontratës dhe rrezikon interesin publik.

Në këtë kontekst, ndryshimi i DST-së ka efekt të dyfishtë problematik, nga njëra anë, zhvendos fokusin nga përputhshmëria teknike reale tek ekzistenca e një autorizimi formal, nga ana tjetër, ul nivelin e transparencës mbi përbërjen, formulimin dhe fushën e aplikimit të produktit. Kjo situatë bie ndesh me parimin e transparencës dhe të konkurrencës së ndershme, pasi operatorët ekonomikë nuk konkurrojnë mbi baza të qarta dhe të krahasueshme teknike, por mbi dokumente formale që mund të mos reflektojnë realisht përputhshmërinë me misionin e kontratës.

Fakti që përdorimi i produktit Aquabac dhe dokumentacioni shoqërues i tij është bërë objekt i hetimeve nga Prokuroria e Posaçme (SPAK) për shkak të dyshimeve mbi mospërputhje me kërkesat ligjore dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara, përbën një element objektiv që autoriteti kontraktor nuk mund ta injorojë. Edhe pse hetimi penal nuk përbën në vetvete provë përfundimtare për fajësi, ekzistenca e tij është një tregues serioz që kërkon rritje të nivelit të kontrollit teknik dhe jo ulje të tij përmes formulimeve të përgjithshme në DST.

Në kushtet kur ekziston një precedent konkret ku autorizimi i importit është përdorur për të legjitimuar një produkt që nuk përmbushte në thelb kriteret teknike të ndërhyrjes, çdo formulim i ri i DST-së që zbeh lidhjen midis organizmave target, dozimit, formulimit

dhe përdorimit konkret në zonat bregdetare krijon rrezik real për efektivitetin e shërbimit dhe për shëndetin publik. Autoriteti kontraktor ka detyrimin pozitiv për të garantuar që produkti i përdorur të jetë jo vetëm i autorizuar formalisht, por i përshtatshëm në mënyrë të provueshme për kushtet konkrete të aplikimit.

Në këtë kuptim, mungesa e transparencës mbi të dhënat reale teknike, si përbërja cilësore dhe sasiore e lëndëve vepruese, spektri i veprimit ndaj organizmave target specifike të zonave bregdetare, dhe përputhshmëria me tipologjinë e ndërhyrjes së kërkuar, cenon drejtpërdrejt parimin e proporcionalitetit dhe të lidhjes së drejtpërdrejtë të kriterit me objektin e kontratës, në kuptim të nenit 77 të ligjit nr. 162/2020.

Për më tepër, lejimi i konsiderimit si “i përshtatshëm” i një produkti që nuk përmbush kuadrin ligjor dhe teknik të biocideve për përdorimin konkret në zonat bregdetare përbën rrezik jo vetëm për efektivitetin e ndërhyrjes, por edhe për mjedisin dhe për shëndetin publik. Kjo e zhvendos çështjen nga një debat formal mbi kriteret e kualifikimit në një çështje të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së interesit publik.

Për rrjedhojë, ndryshimi i DST-së në mënyrën aktuale nuk mund të konsiderohet neutral apo teknikisht i justifikuar, por përbën një devijim që krijon mundësi reale për përfshirjen në procedurë të produkteve që nuk përmbushin standardet ligjore dhe shkencore të kërkuara. Në këto kushte, **autoriteti kontraktor duhet të rikthejë formulimin e qartë dhe të detajuar të kërkesave teknike, duke kërkuar përputhshmëri të drejtpërdrejtë midis organizmave target të autorizimit dhe atyre të përcaktuar në DST, si dhe dokumentacion teknik provues mbi efektivitetin në kushtet konkrete të aplikimit, si autorizim prodhuesi, letër aksesi, certifikatë regjistrimi në një nga vendet e BE-së, USA, Zelandë e Re, Japoni, etj.**

Vetëm një formulim i tillë garanton transparencë, konkurrencë të ndershme dhe mbrojtje reale të interesit publik, duke shmangur përsëritjen e situatave të vitit 2023 dhe duke siguruar që procedura të mos përdoret për të legjitimuar produkte që në thelb nuk përmbushin kriteret teknike të kërkuara.

Kriteri që kërkon paraqitjen e AKT Autorizimit të produktit biocid në momentin e hapjes së ofertave nuk përmbush kërkesën e nenit 77 të ligjit nr. 162/2020, në lidhje me testin e lidhjes së drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, pasi objekti i kontratës është ofrimi i shërbimit të dezinfektimit dhe jo importimi apo vendosja në treg e produktit. **Autorizimi është atribut i produktit dhe lidhet me legjitimitetin e tij për t’u përdorur në territor, ndërsa vlerësimi i ofertës duhet të fokusohet në kapacitetin teknik, profesional dhe organizativ të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin. Vendosja e këtij dokumenti si kriter eliminues në fazën e ofertimit krijon një shkëputje ndërmjet kërkesës dhe aftësisë reale**

15

për ekzekutimin e kontratës, duke e zhvendosur thelbin e vlerësimit nga performanca e pritshme e shërbimit në një element formal që nuk provon në vetvete kapacitetin teknik të operatorit.

Sa i përket ndryshimit të praktikës administrative dhe aplikimit të dy standardeve, fakti që për të njëjtën kategori shërbimi në vitet e mëparshme, përfshirë procedurat e zhvilluara që nga viti 2014, nuk është kërkuar autorizimi i importit si kriter kualifikues, ndërkohë që kontratat janë realizuar me përpikmëri dhe pa probleme në zbatim, tregon mungesë koherence në veprimtarinë e autoritetit kontraktor. Ndryshimi i standardit pa një analizë të dokumentuar teknike dhe pa një arsytim objektiv cenon parimin e sigurisë juridike dhe pritshmërisë së ligjshme të operatorëve ekonomikë, si dhe krijon dyshim të arsyeshëm mbi neutralitetin e kriterit të vendosur, në kundërshtim me parimin e trajtimit të barabartë të parashikuar në ligjin e prokurimit publik.

Në aspektin e efektit strukturor në treg, kërkesa për paraqitjen e autorizimit në momentin e hapjes së ofertave krijon një barrierë hyrjeje që favorizon subjektet që janë njëkohësisht importues ose mbajtës të autorizimeve për produkte specifike, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve të tjerë që kanë kapacitete të plota për kryerjen e shërbimit, por që furnizohen nga tregu i brendshëm me produkte të autorizuara. Një kriter i tillë, në praktikë, mund të ngushtojë artificialisht rrethin e operatorëve pjesëmarrës dhe të krijojë efekt mbyllës të tregut, duke rrezikuar konkurrencën efektive dhe duke rritur kostot për autoritetin kontraktor, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 162/2020.

Nga pikëpamja e proporcionalitetit në kuptimin e ngushtë, kriteri aktual nuk respekton testin e mjetit më pak kufizues. Nëse qëllimi legjitim i autoritetit kontraktor është të garantojë përdorimin e produkteve biocide të autorizuara dhe të shmangë situata të ngjashme me precedentët problematikë të së kaluarës, ky qëllim mund të arrihet përmes mjeteve më pak kufizuese, si paraqitja e autorizimit nga operatori i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës ose përpara fillimit të zbatimit të saj. Vendosja e këtij dokumenti si kriter eliminues në fazën e ofertimit tejkalon atë që është e nevojshme për garantimin e interesit publik dhe përbën barrë të panevojshme administrative dhe financiare për operatorët ekonomikë.

Duke pasur parasysh se precedenti i vitit 2023 lidhur me përdorimin e produktit Aquabac dhe dokumentacionin përkatës është bërë objekt hetimi nga Prokuroria e Posaçme, autoriteti kontraktor ka një detyrim të shtuar për të rritur nivelin e kontrollit substancial mbi përputhshmërinë teknike reale të produkteve me organizmat target dhe kushtet konkrete të aplikimit, dhe jo për ta reduktuar kontrollin në verifikimin formal të ekzistencës së një akti administrativ. Formulimi aktual i kriterit, i cili nuk kërkon përputhje të drejtpërdrejtë midis

16

ërmbla t'es së autorizimit dhe kërkesave teknike të DST-së kri'on rrezik ër ërsërit'en e roblematikave të më arshme dhe ër cenimin e efektivitetit të shërbimit duke e bërë të domosdoshme rishikimin e ti' në funksion të mbro't'es së interesit ublic dhe trans arencës së rocedurës.

Fakti që në procedurat e mëparshme të së njëjtës kategori, përfshirë ato të viteve 2014 e në vijim, autorizimi i importit nuk është kërkuar si kriter kualifikues, ndërkohë që kontratat janë zbatuar me përpikmëri dhe realizim të plotë, dëshmon se ky dokument nuk ka qenë i domosdoshëm për garantimin e ekzekutimit të kontratës. Kjo krijon një situatë të qartë të mungesës së koherencës administrative dhe cenon parimin e sigurisë juridike dhe të pritshmërisë së ligjshme.

Një autoritet kontraktor nuk mund të ndryshojë standardin e kërkesave pa një arsytim objektiv dhe të dokumentuar, sidomos kur bëhet fjalë për një procedurë të përsëritur në kohë dhe për një kategori shërbimi të konsoliduar. Ndryshimi i standardit pa motivim teknik krijon dyshim të arsyeshem mbi neutralitetin e kërkesës dhe cenon parimin e trajtimit të barabartë.

Nëse kërkesa për autorizim importi paraqitet si mjet për të siguruar transparencë mbi përbërjen dhe cilësitë e produktit, atëherë ky qëllim mund të arrihet përmes mekanizmave më të drejtpërdrejtë dhe më pak kufizues, si kërkimi i dosjes teknike të produktit, kërkimi i dokumentacionit mbi efektivitetin ndaj organizmave target, apo verifikimi teknik nga TAECHS ose nga struktura kompetente e ISHP.

Pra, nëse qëllimi është garantimi i përshtatshmërisë biologjike të produktit, atëherë duhet kërkuar dokumentacioni teknik për efektivitetin ndaj organizmave target, jo një autorizim importi që mund të jetë marrë mbi bazë dokumentacioni të diskutueshem ose madje të falsifikuar, siç rezulton të jetë nën hetim nga SPAK për procedurën e vitit 2023.

Precedenti i vitit 2023, ku autorizimi i importit ka rezultuar i lidhur me përdorim të dokumentacionit të falsifikuar për përfitimin e tenderit dhe ku për këtë çështje është paraqitur kallëzim penal dhe vijon hetimi nga Prokuroria e Posaçme, forcon argumentin se autorizimi i importit, si kriter formal, nuk është garanci për ligjshmërinë dhe cilësinë e produktit. Përkundrazi, ai mund të përdoret si mburojë formale për të maskuar probleme substanciale teknike. Kjo situatë e bën edhe më të domosdoshme që kriteri të fokusohet në përputhshmërinë reale teknike të produktit me organizmat target dhe me misionin e ndërhyrjes, jo në ekzistencën e një akti administrativ formal.

Kërkesa për autorizim importi, në kushtet kur nuk është kërkuar historikisht dhe kur kontratat janë realizuar me sukses, krijon një standard të ri që kufizon aksesin në treg për operatorë që përdornn produkte të autorizuara tashmë në territor, por që nuk janë vetë

17

importues. Kjo kufizon konkurrencën në favor të subjekteve që kanë kontroll mbi zinxhirin e importit dhe krijon avantazh strukturor të padrejtë.

Nga analiza e dokumentacionit teknik dhe ligjor të produkteve biocide që mund të paraqiten në kuadër të kësaj procedure, rezulton se ekziston një mospërputhje thelbësore midis statusit formal të autorizimit dhe përmbushjes reale të kërkesave ligjore dhe teknike të përcaktuara në legjislacionin shqiptar dhe në Dokumentet Standarde të Tenderit. Konkretisht, në rast se produkti paraqitet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ai nuk mund të përmbushë kushtet për autorizim dhe regjistrim në Republikën e Shqipërisë, për shkak se lënda aktive përkatëse nuk rezulton e përfshirë në listën e substancave të miratuara sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 933, datë 25.11.2020, i cili përcakton kriteret dhe procedurat për autorizimin e produkteve biocide dhe përfshirjen e lëndëve aktive të lejuara për përdorim në territorin e Republikës së Shqipërisë. Për rrjedhojë, një produkt i mbështetur mbi këtë bazë dokumentare nuk përmbush kushtet ligjore për t'u konsideruar produkt biocid i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi.

Nga ana tjetër, në rast se produkti paraqitet mbi bazën e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet franceze, analiza teknike evidenton se autorizimi nuk është i lidhur drejtpërdrejt me prodhuesin origjinal të produktit ose nuk garanton përputhshmëri të plotë me formulimin dhe përdorimin e kërkuar, ndërkohë që lënda aktive e përdorur, edhe nëse konsiderohet teknikisht ekuivalente, nuk garanton efikasitet biologjik kundër të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave që përbëjnë objektin e ndërhyrjes sipas specifikimeve teknike të DST-së. Në këto kushte, ekzistenca e një autorizimi formal nuk provon në vetvete përmbushjen e kërkesave funksionale dhe teknike të kontratës, të cilat kërkojnë qartësisht kontroll efektiv dhe të plotë të organizmave target.

Në këtë kontekst, formulimi aktual i DST-së, i cili redukton kontrollin teknik dhe ligjor vetëm në ekzistencën e një akti autorizimi, krijon një hapësirë të pajustificuar interpretimi në fazën e vlerësimit të ofertave dhe nuk garanton verifikimin e plotë të përputhshmërisë së produktit me kërkesat ligjore dhe teknike. Ndryshe nga procedurat e mëparshme, ku kërkohej dokumentacion i plotë teknik dhe ligjor që i mundësonte autoritetit kontraktor të kryente një vlerësim të plotë mbi përbërjen, efektivitetin dhe përshtatshmërinë e produktit, formulimi aktual kufizon kontrollin në një dokument të vetëm formal, mbi bazën e të cilit nuk mund të verifikohet në mënyrë të plotë përputhshmëria reale e produktit me objektin e kontratës.

Një qasje e tillë cenon drejtpërdrejt parimet themelore të prokurimit publik, në veçanti parimin e transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë, pasi krijon mundësinë që produkte të cilat nuk përmbushin plotësisht kërkesat teknike të konsiderohen të pranueshme

16

vetëm mbi bazën e ekzistencës së një autorizimi formal, pa u verifikuar përmbajtja dhe fushëveprimi real i këtij autorizimi. Për më tepër, kjo situatë cenon edhe parimin e sigurisë juridike, pasi operatorët ekonomikë nuk mund të përcaktojnë me qartësi kriteret reale mbi të cilat do të vlerësohet përputhshmëria teknike e produkteve të ofruara.

Në kushtet aktuale, produkti është autorizuar në Republikën e Shqipërisë, çka nënkupton se autorizimi është mbështetur mbi dokumentacion të paraqitur nga një juridiksion i huaj, konkretisht dokumentacion francez. Megjithatë, analiza teknike e karakteristikave të produktit dhe e fushës së përdorimit të tij evidenton se ai nuk garanton efikasitet të plotë kundër të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave që përbëjnë objektin e ndërhyrjes sipas specifikimeve teknike të procedurës. Në këto kushte, autorizimi formal nuk mund të konsiderohet provë e mjaftueshme për përputhshmërinë me kërkesat teknike të kontratës, pasi ligji dhe dokumentet e tenderit kërkojnë jo vetëm ekzistencën e autorizimit, por edhe përputhshmërinë funksionale dhe teknike me objektin konkret të ndërhyrjes.

Autorizimi administrativ i një produkti biocid nuk mund të prevalojë mbi detyrimin ligjor të autoritetit kontraktor për të garantuar që produkti i përdorur përmbush plotësisht specifikimet teknike të përcaktuara në DST. Nëse produkti nuk garanton kontroll efektiv të të gjitha organizmave target të përcaktuar në specifikimet teknike, atëherë ai nuk mund të konsiderohet i përshtatshëm për realizimin e objektit të kontratës, pavarësisht ekzistencës së një autorizimi formal.

Për më tepër, formulimi aktual i DST-së ka efektin praktik të fshehjes ose relativizimit të të dhënave reale teknike dhe ligjore mbi produktin Aquabac, duke krijuar një situatë konfuzioni dhe mungese transparence në procesin e vlerësimit. Kjo krijon mundësinë që një produkt që nuk përmbush plotësisht kërkesat ligjore dhe teknike të konsiderohet i pranueshëm në procedurë, në kundërshtim me qëllimin e ligjit për prokurimin publik dhe me interesin publik për garantimin e efektivitetit të ndërhyrjes. Ky aspekt merr rëndësi të veçantë edhe për faktin se përdorimi i këtij produkti dhe dokumentacioni përkatës kanë qenë objekt hetimi nga organet kompetente, çka nënvizon nevojën për një nivel më të lartë transparence dhe verifikimi teknik, dhe jo për reduktimin e standardeve të kontrollit përmes formulimeve të përgjithshme në DST. Në këto kushte, lejimi i përdorimit të një produkti që nuk provon në mënyrë të qartë përputhshmërinë me kërkesat teknike dhe ligjore nuk është i justifikueshëm dhe bie në kundërshtim me detyrimin e autoritetit kontraktor për të garantuar realizimin efektiv dhe të ligjshëm të kontratës.

Në këtë kuptim, kërkesa për autorizim importi duhet të vlerësohet jo vetëm si kriter teknik, por si kriter me efekt potencial diskriminues, në kundërshtim me nenin 3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Për të gjitha këto arsye, kërkesa për Autorizim Importi, si kriter kualifikues në fazën e ofertimit, rezulton e panevojshme në raport me historikun e procedurës, e papërshtatshme për garantimin e përputhshmërisë teknike reale, e pajustificuar në mungesë të një arsytimi të dokumentuar dhe potencialisht kufizuese dhe diskriminuese në raport me operatorë që nuk janë vetë importues.

Referuar nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, kriteret e kualifikimit duhet të jenë:

- të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës
- proporcionale
- të nevojshme për garantimin e kapaciteteve të OE

Për rrjedhojë, në kuadër të këtij ankimi, kërkojmë heqjen e kërkesës për Autorizim Importi si kriter kualifikimi, duke e zëvendësuar atë me kërkesë për dokumentacion teknik që provon efektivitetin dhe përshtatshmërinë e produktit ndaj organizmave target të përcaktuar në DST, në mënyrë që të garantohet realisht misioni i ndërhyrjes dhe të ruhet konkurrenca e ndershme në treg.

Për sa më sipër, kërkojmë:

- Pranimin e ankesës si të ligjshme dhe të bazuar;
- Pezullimin e procedurës së prokurimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar;
- Shtimin dhe ndryshimin e kriterëve të kundërshtuar në DST;
- Detyrimin e Autoritetit Kontraktor për përputhjen e dokumentacionit me ligjin.

II.7. Me shkresën me nr. 03 prot., datë 27.02.2026 me lëndë “Sërish në vijim të ankimit: A/2026/6351, A/2026/6362, A/2026/6353, A/2026/6354, A/2026/6355” protokolluar me tonën me nr. 548/3 prot., datë 02.03.2026 operatori ekonomik “NRG” SHPK ka paraqitur në KPP argumenta me përmbajtje si vijon:

’ Nderuar

ç jeni në dijëni në kuadër të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur mbi kufirin e lartë monetar” me objekt “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane”, e ndarë në 5 lote nga AK OBP, subjekti ynë ka paraqitur ankesë ndaj Dokumenteve Standarde të Tenderit (DST), duke evidentuar standardet e dyfishta të aplikuar ndërmjet Lotit 1 dhe loteve të tjera, si dhe përcaktimin e kriterëve që kufizojnë haptazi konkurrencën dhe, për më tepër, rrezikojnë realizimin efektiv të kontratës publike në përputhje me qëllimin e saj.

Jemi njohur me Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave nr. 29 2026, datë 25.02.2026, me të cilin është refuzuar kërkesa jonë për ndryshimin e DST.

Arsyetimet e parashtruara në këtë vendim janë shqyrtuar me vëmendje dhe vlerësim serioz nga ana jonë; megjithatë, asnjë prej tyre nuk qëndron, nuk është i mbështetur në kuadrin ligjor dhe interpretimet e bëra janë në shkelje të tij

Theksojmë se i përmbahemi plotësisht dhe pa asnjë rezervë ankimit të paraqitur me datë 20.02.2026, si dhe plotësimin të tij me datë 26.02.2026.

Në vijim, në reflektim të arsyetimeve të përmbajtura në Vendimin nr. 29 2026, parashtrojmë kundërshtimet tona shtesë, në funksion të një analize më të plotë të çështjes dhe të evidentimit të cenimeve konkrete të ligjit, të konkurrencës në këtë procedurë prokurimi.

1. Thelbi i ankimit tone duke ekspozuar se ‘Për Lotin 1 “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Shkodër”

→ Nuk kërkohet paraqitja e bilanceve vjetore të shoqëruara me akt-ekspertizë kontabël dhe Nuk kërkohet verifikimi i raportit aktiv/pasiv ndryshe nga kriteret për lot-et e tjera të procedurës

te interpretuar nga KSHA në vendimin e saj 29 2026, sikur kërkesa jonë konsiston për shtim të kriterëve të kualifikimit

Në ankimin e paraqitur, NRG nuk ka kërkuar në asnjë shtimin e një kriteri të ri kualifikimi për Lotin 1, por ka evidentuar diferencimin ekstrem dhe të pajustificuar të kriterëve ekonomiko-financiare ndërmjet Lotit 1 dhe Loteve 2–5, brenda së njëjtës procedurë prokurimi dhe për të njëjtin lloj shërbimi.

Perserisim se vendosja e pragut 40% të xhiros dhe 20% eksperiencë për Lotin 1, krahasuar me 100% xhiro, bilance të ekspertizuara, raport pozitiv aktiv/pasiv dhe 40% eksperiencë për lotet e tjera, krijon një standard të dyfishtë, jo proporcional dhe alogjik, që cenon barazinë dhe konkurrencën.

Thelbi i pretendimit ka qenë mungesa e koherencës dhe proporcionalitetit në ndërtimin e kriterëve, jo kërkesa për shtimin e pasqyrave financiare si kriter i ri.

Në Vendimin nr. 29/2026, KSHA ka arsyetuar se

- pretendimi i NRG nuk përbën kundërshtim të një kriteri ekzistues të përcaktuar në DST, por konsiston në kërkesën për shtimin e një specifike shtesë (paraqitjen e pasqyrave financiare vjetore), çka përbën shtim kriteri kualifikimi të paparashikuar në dokumentet e tenderit.
- e drejta e ankimit, sipas nenit 109 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, kufizohet në verifikimin e ligjshmërisë së kriterëve ekzistues dhe nuk shtrihet në imponimin e kriterëve të reja.
- përcaktimi i kriterëve të kualifikimit është kompetencë ekskluzive e Autoritetit Kontraktor dhe se çdo ndërhyrje për shtimin e kërkesave të reja do të cenonte diskrecionin e tij dhe stabilitetin e dokumenteve të tenderit.
- çdo lot përbën një njësi të pavarur vlerësimi, me fond limit dhe kërkesa specifike të veçanta, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, dhe se për Lotin 1 kërkesa për xhiro 40% është brenda kufirit maksimal të lejuar nga rregullorja, duke e konsideruar kriterin proporcional me vlerën e fondit limit.

Sic shihet Arsyetimi i KSHA bazohet mbi një keqinterpretim thelbësor të objektit të ankimit. NRG nuk ka kërkuar shtimin e një kriteri të ri për Lotin 1, por ka kundërshtuar diferencimin e pajustificuar ndërmjet loteve, i cili cenon parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe konkurrencës.

- Pretendimi nuk ka qenë thjesht “të shtohen pasqyrat financiare për Lotin 1”, por “pse për lote të njëjta në natyrë dhe objekt aplikohen standarde drastikisht të ndryshme kualifikimi?”.
- Kjo është një çështje e serioze e ligjshmërisë të kriterëve ekzistues, pra bie qartazi brenda objektit të ankimit sipas Ligjit nr. 162/2020.
- Reduktimi i argumentit të ankuesit në një kërkesë për shtim kriteri përbën deformim të përmbajtjes së ankimit dhe shmang thelbin e problemit: standardin e dyfishtë brenda së njëjtës procedurë.
- Edhe nëse, ose edhe pse, çdo lot konsiderohet njësi e pavarur, kjo nuk e përjashton detyrimin e Autoritetit Kontraktor për të ruajtur koherencë logjike ndërmjet kriterëve të loteve që kanë të njëjtin

objekt shërbimi. Diskrecioni administrativ nuk është i pakufizuar; ai duhet të ushtrohet në përputhje me parimet e nenit 2 të Ligjit nr. 162/2020.

- Fakti që për Lotin 1 kërkesa për xhiro është brenda kufirit maksimal 40% nuk e zgjidh kontradikten.
- Çështja nuk është tejkalmi i kufirit maksimal, por diferencimi ekstrem 40% kundrejt 100%, i shoqëruar me shtim filtrash financiarë vetëm për disa lote.
- Ligji vendos kufij maksimalë, por nuk justifikon vendosjen e standardeve të pabarabarta pa një analizë objektive të riskut dhe kompleksitetit të secilit lot.

Pretendimi i KSHA se shtimi i kriterëve do të cenonte barazinë është logjikisht i pabazë.

- Barazia cenohet pikërisht nga trajtimi i ndryshëm i situatave të njëjta.
- Kur brenda së njëjtës procedurë për të njëjtin shërbim vendosen pragje drastikisht të ndryshme atëherë krijohet qarte jo thjesht perceptimi por bindja për integritetin e gares

Në përfundim, vendimi nr. 29/2026 nuk i përgjigjet thelbit të ankimit, por e riformulon atë në mënyrë artificiale për ta shpallur të papranueshëm. Për rrjedhojë, ai duhet të shfuqizohet nga Komisioni i Prokurimit Publik, si një vendimmarrje që nuk trajton në substancë pretendimin për cenim të proporcionalitetit dhe konkurrencës në këtë procedurë prokurimi.

Sipas Vendimit të KSHA pershkruhet edhe se

- përcaktimi i viteve për xhiron vjetore është bërë në referim të nenit 43, pika 1 të VKM nr. 285/2021, si dhe në përputhje me nenin 61 të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe Ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”

ndersa në fakt pikërisht këto dispozita janë shkelur në rastin e DST së lot-it 1, për me tepër në aplikim të standardit të dyfishtë krahasuar me lot-et e tjera.

Pra çështja nuk qëndron në referimin formal të baza ligjore për kërkimin e xhiros apo bilanceve, por në aplikimin selektiv dhe të pjesshëm të këtyre kërkesave në Lotin 1, duke krijuar një standard të ndryshëm nga lotet e tjera dhe njëkohësisht një standard të cunguar të mbikeeqyrjes. Konkretisht evidentojmë serish se:

- Në Lotin 1 kërkohen bilance vjetore të shoqëruara me akt-ekspertizë kontabël, por nuk kërkohet verifikimi i raportit aktiv/pasiv;
- Ndërkohë që në lote të tjera vendosen filtra financiarë shtesë dhe raporti aktiv/pasiv trajtohet si element kualifikues.

Ky formulim bie ndesh me vetë logjikën e nenit 43, pika 6 të VKM nr. 285/2021, i cili parashikon se dokumentet financiare “i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës”.

- Nëse qëllimi është njohja reale e gjendjes financiare, atëherë analiza nuk mund të kufizohet në administrimin formal të bilanceve, pa vlerësimin e treguesve thelbësorë financiarë, siç është raporti ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Pa këtë verifikim, paraqitja e bilanceve mbetet një formalitet pa përmbajtje substanciale.
- Në fakt, procesi i administrimit dhe vlerësimit të bilanceve përbën një formë mbikëqyrjeje publike mbi qëndrueshmërinë financiare të operatorëve ekonomikë.

Evidentojme se madje, ekzistojnë vendimmarrje të mëparshme të vetë KSHA nee AK, ku janë pranuar kërkesa të operatorëve ekonomikë për modifikimin e DST, pikërisht në drejtim të standardizimit të analizës financiare, konkretisht se ka vendimmarrje të KSHA ne te cilat:

- kriteri fillestar në DST parashikonte që operatorët ekonomikë duhet të paraqisnin bilancet vjetore për vitet financiare përkatëse, dhe kërkesa konsiderohej e përmbushur nëse, në dy bilance të njëpasnjëshme të kërkuara, nuk rezultonte raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.
- Pas ankimeve, KSHA ka vendosur modifikimin e këtij kriteri në DST, duke kërkuar bilance të certifikuar, të paraqitura pranë autoriteteve tatimore, dhe në rastet qee OE ndodhet në kushtet e përcaktuara në nenin 41 të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

1. Në ankimin e paraqitur, NRG ka argumentuar se

- kriteri 2.3.2 – që kërkon paraqitjen e Akt-Autorizimit të produktit biocid në momentin e ofertimit, i kombinuar me ndalimin absolut të mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të treta – përbën një kufizim të pajustificuar dhe strukturalisht diskriminues të konkurrencës.
- sipas kuadrit rregullator sektorial dhe në veçanti VKM nr. 933, datë 25.11.2020, autorizimi është akt administrativ që lidhet me produktin biocid dhe legalizon vendosjen e tij në treg, ndërsa e drejta për tregtim lidhet me licencimin e subjektit.
- Legjislacioni nuk kërkon që çdo përdorues i produktit të jetë vetë mbajtës i autorizimit. Për rrjedhojë, kërkesa që operatori ekonomik të jetë vetë mbajtës i aktit të autorizimit dhe ndalimi i mbështetjes në kapacitete të treta shndërron një kriter teknik mbi produktin në një barrierë hyrjeje në treg, duke

përrjashtuar operatorë të licencuar, me kapacitete të plota teknike dhe profesionale, që përdorin produkte ligjërisht të autorizuar.

- autorizimi i importit nuk garanton në vetvete përputhshmërinë teknike me organizmat target të DST-së dhe se precedenti i vitit 2023 ka provuar se kontrolli teknik substancial është elementi vendimtar, jo ekzistenca formale e autorizimit. Në këtë kuptim, kriteri aktual jo vetëm kufizon konkurrencën, por njëkohësisht redukton kontrollin real teknik mbi produktin.

Sipas Vendimit nr. 29/2026, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka parashtruar se

- kërkesa për paraqitjen e Akt-Autorizimit të produktit biocid është e justifikuar teknikisht dhe ligjërisht, duke u mbështetur në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligjin nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 dhe VKM nr. 933, datë 25.11.2020.
- produktet larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringiensis israelensis* (B.t.i.) ose ekuivalente janë produkte me veprim biologjik aktiv dhe përdorimi i tyre në habitate ujore të hapura dhe ambiente të mbyllura kërkon kontroll rigoroz mbi përbërjen, stabilitetin, sigurinë për organizma jo-target dhe efektivitetin minimal dy-javor – dhe se këto elemente verifikohen përmes procesit të autorizimit nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dokumentohen në Akt-Autorizim.
- produkti biocid është element thelbësor i ofertës teknike dhe jo element i fazës së ekzekutimit, ndaj operatori duhet të provojë në momentin e ofertimit se disponon produkt të autorizuar.
- kërkesa nuk kufizon konkurrencën, por garanton ligjshmërinë dhe sigurinë e shërbimit, duke qenë se përdorimi i produkteve biocide pa autorizim është i ndaluar nga ligji.
- për shkak se Akt-Autorizimi është akt administrativ individual i lidhur me subjektin mbajtës dhe me përgjegjësinë ligjore për produktin, është në diskrecionin e Autoritetit Kontraktor të mos lejojë mbështetje në subjekte të tjera për këtë kriter, duke e konsideruar këtë ndalim të arsyetuar dhe proporcional me natyrën e shërbimit.

Sic shihet arsyetimi i KSHA ngatërron natyrën juridike të Akt-Autorizimit të produktit biocid.

- a. Sipas VKM nr. 933, datë 25.11.2020, autorizimi është një akt administrativ që lidhet me produktin (përbërjen, lëndën vepruese, formulimin, klasifikimin, kushtet e përdorimit dhe sigurinë), jo me kapacitetin profesional apo ekonomik të operatorit që e përdor atë në një kontratë shërbimi. Autorizimi legalizon vendosjen në treg të produktit; ai nuk përbën provë të aftësisë teknike të operatorit ekonomik për të realizuar shërbimin. Këto janë dy gjera të ndryshme

Duke e trajtuar autorizimin si element të lidhur domosdoshmërisht me subjektin ofertues, KSHA i jep atij një efekt që ligji sektorial nuk e parashikon. Legjislacioni për biocidet kërkon që produkti të jetë i autorizuar për t'u vendosur në treg; ai nuk kërkon që çdo tregtues i produktit të jetë vetë mbajtës i aktit të autorizimit.

Në këtë kuptim, kërkesa që operatori të jetë domosdoshmërisht mbajtës i autorizimit krijon një kufizim që nuk rrjedh nga ligji.

- b. KSHA e justifikon këto kriter me argumentin e sigurisë dhe efektivitetit të produktit (p.sh. kontrolli mbi B.t.i., stabiliteti, organizmat jo-target etj.) - mirepo këto janë elemente që verifikohen në fazën e autorizimit të produktit dhe në dokumentacionin teknik të tij, jo në identitetin juridik të operatorit që e përdor.

Nëse qëllimi i këtij kriteri është garantimi i përputhshmërisë me organizmat target të DST, efektivitetit minimal dy-javor dhe siguria e efektit për organizma jo-target - atëherë mjete të përshtatshëm është kërkimi i dosjes teknike të produktit, fletëve të të dhënave të sigurisë, raporteve të efikasitetit, certifikatave analitike apo verifikimi nga struktura teknike kompetente.

Akt-Autorizimi në vetvete nuk garanton që produkti i përzgjedhur është biologjikisht optimal për organizmat target të përcaktuar në këtë procedurë konkrete. Ai garanton vetëm që produkti është i ligjshëm për t'u vendosur në treg në Republikën e Shqipërisë.

Për më tepër, precedenti i procedurës së vitit 2023 (rasti Aquabac) tregon qartë se ekzistenca e autorizimit nuk e pengoi përdorimin e një produkti që nuk përmbushte në substancë kërkesat teknike të DST. Pra, autorizimi nuk është garanci automatike e përputhshmërisë reale teknike.

Në këtë kontekst, kriteri aktual nuk është mjete më i përshtatshëm për arritjen e qëllimit legjitim (mbrojtja e shëndetit publik dhe efektiviteti i ndërhyrjes), por thjesht kufizon gareen e rrit rrezikun e mospërbushjes së qëllimit të kontratës.

- c. Ligji nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" njihet në mënyrë eksplicite të drejtën e operatorit për t'u mbështetur në kapacitetet e subjekteve të tjera për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit, përveç rasteve kur natyra e kriterit e bën këtë objektivisht të pamundur.

Në rastin konkret, Akt-Autorizimi është një dokument që provon se produkti është i autorizuar për vendosje në treg. Nuk ka asnjë element teknik apo juridik që e bën të pamundur që një operator ekonomik të furnizohet nga një mbajtës autorizimi, të paraqesë marrëveshje furnizimi, dhe të përdorë produkt të autorizuar ligjërisht.

Ndalimi absolut i mbështetjes në palë të treta nuk është i domosdoshëm për garantimin e sigurisë së produktit. Përkundrazi, ai krijon avantazh për subjektet importuese dhe përjashton operatorë të licencuar që përdorin produkte të autorizuara, por nuk janë vetë importues.

Ky kriter ngushton artificialisht rrethin e konkurrencës, transferon kontrollin e tregut tek një numër i kufizuar subjektësh duke krijuar barrierë për subjekte të tjera aplikues që nuk buron nga ligji.

- d. Diskrecioni i Autoritetit Kontraktor për të vendosur kritere kualifikimi nuk është i pakufizuar; ai duhet të ushtrohet në përputhje me parimet themelore të së drejtës administrative, në veçanti me parimin e proporcionalitetit të sanksionuar në nenin 12 të Kodit të Procedurave Administrative.

Sipas këtij neni, çdo veprim administrativ që kufizon një të drejtë apo cenon interesa legjitime është i ligjshëm vetëm nëse është i nevojshëm, i përshtatshëm dhe në përpjesëtim të drejtë me qëllimin që synon të arrijë.

Në kontekstin e prokurimit publik, kjo do të thotë se kriteret e kualifikimit duhet të jenë të domosdoshme për garantimin e realizimit të kontratës, të afta realisht për të arritur këtë qëllim dhe të mos shkojnë përtej asaj që është e nevojshme, duke kufizuar konkurrencën më shumë se sa kërkon interesi publik.

Kur vendosen kritere që krijojnë barrierë hyrjeje të panevojshme, aplikohen në mënyrë selektive ndërmjet loteve, ose përdoren si filtra formalë pa lidhje të drejtpërdrejtë me aftësinë reale për të realizuar kontratën, atëherë tejkalohet kufiri i diskrecionit administrativ dhe cenohet parimi i proporcionalitetit.

Në këto kushte, vendosja e kriterëve të tilla nuk mund të justifikohet thjesht me referim formal në ligj, por duhet të provohet se ato përmbushin thelbesisht kërkesat ligjore - gjë që në rastin konkret nuk rezulton të jetë bërë.

- e. Referimi i KSHA në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr. 162/2020 dhe në nenin 41, pika 4, gërma "a" të VKM nr. 285/2021 nuk e mbështet, por përkundrazi e rrëzon arsyetimin e saj.

→ Neni 77/4 lejon vendosjen e kërkesave që lidhen me aftësitë teknike dhe profesionale të operatorit ekonomik, pra me burimet njerëzore, teknike dhe përvojën e tij për zbatimin e kontratës, jo me posedimin në emër të vet të një akti administrativ që lidhet me autorizimin e një produkti.

→ Po kështu, neni 41/4/a i Rregullave të Prokurimit Publik parashikon qartësisht si mjet prove "licenca profesionale për realizimin e shërbimeve", të lëshuara nga autoritetet kompetente, dhe jo detyrimin që operatori të jetë mbajtës i autorizimit të importit apo autorizimit të produktit në

emrin e tij - Pra, rregullorja flet për licencim të subjektit për ushtrimin e veprimtarisë, jo për zotërim individual të aktit të autorizimit të produktit.

→ Edhe referimi në nenet 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9108/2003 “Për substancat dhe preparatet kimike” është jashtë kontekstit të prokurimit, pasi këto dispozita rregullojnë regjistrimin dhe administrimin e substancave nga prodhuesi, importuesi apo shpërndarësi, pra raportin e tyre me autoritetet shtetërore për qëllime sigurie dhe mbrojtjeje të mjedisit, dhe jo kriteret e kualifikimit në një procedurë tenderimi.

Asnjë nga këto norma nuk vendos detyrimin që operatori ofertues në një procedurë prokurimi të jetë vetë mbajtës i autorizimit të importit; përkundrazi, ato konfirmojnë ndarjen midis (i) ligjshmërisë së produktit në treg dhe (ii) kapacitetit profesional të subjektit për të kryer shërbimin.

Për rrjedhojë, mbështetja e KSHA në këto dispozita për të justifikuar ndalimin e mbështetjes në palë të treta dhe detyrimin për zotërim individual të autorizimit përbën interpretim jo të mbështetur në ligj.

f. Pretendimi i KSHA për “mospërputhje në qëndrime” është i pabazuar dhe përbën një insinuatë ndaj NRG, e cila nuk i shërben analizës juridike të çështjes.

Detyra e KSHA është të vlerësojë ligjshmërinë e kriterit të kontestuar në raport me kuadrin normativ dhe parimet e prokurimit publik, jo të bëjë krahasime selektive me qëndrime të mëparshme të operatorit ekonomik, pa evidentuar qartë kontekstin dhe arsyetimin konkret të tyre.

Edhe nëse hipotetiki do të ekzistonte një ndryshim qëndrimi në kohë, kjo nuk përbën argument për ligjshmërinë e kriterit aktual. Ligjshmëria e një kërkesë në DST vlerësohet objektivisht në raport me ligjin, rregullat e prokurimit dhe parimet e proporcionalitetit, barazisë dhe konkurrencës, jo në raport me pozicionimet e mëparshme të një operatori ekonomik.

Për rrjedhojë, referimi i KSHA në “mospërputhje qëndrimesh” nuk ka peshë juridike dhe nuk mund të shërbejë si bazë për rrëzimin e ankimit, pasi ai nuk adreson thelbin e kontestimit dhe shmang analizën e vetë kriterit të vendosur në DST.

Në dritën e sa më sipër:

- Akt-Autorizimi është dokument që lidhet me produktin, jo me identitetin e operatorit;
- ai nuk garanton automatikisht përputhshmëri teknike me organizmat target të kësaj procedure;
- ndalimi absolut i mbështetjes në kapacitete të treta është masë më kufizuese se sa e nevojshme për arritjen e qëllimit legjitim.

për rrjedhojë, kriteri 2.3.2, në formulimin aktual, përbën kufizim joproportional dhe diskriminues të konkurrencës dhe duhet të rishikohet, duke u zëvendësuar me kërkesa që garantojnë realisht efektivitetin teknik të produktit pa deformuar aksesin në treg.

II.8. Me shkresën nr. 05 prot., datë 03.03.2026 me lëndë “Në vijim të ankimit A/2026/6351, A/2026/6362, A/2026/6353, A/2026/6354, A/2026/6355 protokolluar me tonën me nr. 548/4 prot., datë 04.03.2026 operatori ekonomik “NRG” SHPK ka vënë në dijeni KPP se lidhur me çështjet e arsyetuara në ankim i është drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me shkresën nr. 04 prot., datë 03.03.2026 bashkëlidhur, me përmbajtje si vijon:

“

Të Nderuar

Shoqëria NRG sh.p.k., me NIPT L13426006B, ushtron aktivitet në fushën e shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit, duke ofruar shërbime me cilësi të lartë dhe të certifikuara për mbrojtjen e shëndetit publik.

Prej vitesh, shoqëria jonë është një partner i besueshëm institucional, fakt i konfirmuar përmes realizimit me sukses të kontratave të rëndësishme publike dhe private në këtë sektor, në përputhje të plotë me standardet teknike dhe kërkesat ligjore në fuqi.

Në funksion të garantimit të ushtrimit të shërbimeve të dezinfektimit, dezinfektimit dhe deratizimit në përputhje të plotë me kuadrin rregullator për tregtimin dhe përdorimin e produkteve biocide, shoqëria jonë i kushton vëmendje të veçantë njohjes dhe zbatimit rigoroz të akteve normative në fuqi.

Në mënyrë të veçantë, kemi ndjekur me kujdes dhe kemi zbatuar në praktikë aktet rregullatore të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë, përfshirë përditësimet e tyre, veçanërisht ato që lidhen me autorizimet e dhëna në zbatim të VKM nr. 933, datë 25.11.2020, “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Dihet se kërkesat e tregut, si në kontratat publike ashtu edhe në ato private kudo, fokusohen në kontrollin e vektorëve specifikë që paraqesin rrezik për shëndetin publik.

Specifikisht këtu në Shqipëri, ndërhyrjet e kërkuara konsistojnë në luftimin e mushkonjave të gjinisë *Aedes*, *Culex* dhe, veçanërisht në zonat bregdetare, të gjinisë *Anopheles*, kjo e fundit me rëndësi të veçantë për shkak të rolit të saj si vektor i malaries.

Për rrjedhojë, përzgjedhja dhe përdorimi i produkteve biocide duhet të jetë i orientuar drejt efektivitetit të provuar ndaj këtyre organizmave target, në përputhje me kërkesat teknike të çdo kontrate dhe me standardet e mbrojtjes së shëndetit publik

Në këtë kuadër, kemi nevojë dhe kërkojmë informacion zyrtar lidhur me disponueshmërinë në tregun shqiptar të një produkti biocid që është i pajisur me autorizim importi të vlefshëm, është i autorizuar për vendosje në treg në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rezulton i destinuar për luftimin e të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave, përfshirë edhe ato të gjinisë *Anopheles*.

Pra lidhur me këtë produkt biocid, kërkojmë informacion zyrtar nga ana Juaj:

1. Aktualisht produkti a rezulton i disponueshëm në tregun shqiptar dhe me autorizim të vlefshëm?
2. Sipas aktit të autorizimit të lëshuar, a konfirmohet shprehimisht efektiviteti i tij për luftimin e të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave, përfshirë ato të gjinisë *Anopheles*;
3. Në kuadër të miratimit të autorizimit, a janë administruar dhe vlerësuar dokumentacioni teknik dhe ligjor
 - ↳ që provon vetitë biologjike dhe efikasitetin e produktit ndaj të gjitha llojeve të larvave dhe
 - ↳ që lidhen me mënyrën e furnizimit, kapacitetet e disponueshmërisë dhe afatet e dorëzimit në treg.

Ky sqarim është thelbësor për garantimin e përputhshmërisë së produkteve të përdorura me kërkesat ligjore dhe me nevojat reale të ndërhyrjes në shëndetin publik

Evidentojmë se sipas verifikimeve të kryera nga specialistët tanë, në bazë të të dhënave publike të disponueshme, përfshirë informacionin e publikuar nga European Chemicals Agency (ECHA), nuk rezulton ekzistenca e një produkti biocid të regjistruar në R.Sh, për të cilin të jetë i dokumentuar në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme efektiviteti kundër larvave të mushkonjave të gjinisë *Anopheles*.

Për këtë arsye, vlerësojmë të nevojshme një sqarim zyrtar nga ana Juaj lidhur me këtë çështje, në funksion të garantimit të përdorimit të produkteve që përmbushin standardet teknike dhe kërkesat e shëndetit publik.

Sa më sipër parashtrohet jo vetëm si nevojë për sqarim teknik, por edhe në funksion të garantimit të konkurrencës së ndershme në treg dhe të mbrojtjes së shëndetit publik.

Në praktikë, vihet re se autorizimet e lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë paraqiten nga operatorë të caktuar si akte që konfirmojnë automatikisht efektivitet të garantuar për luftimin e të gjitha llojeve të larvave të mushkonjave, përfshirë edhe ato të gjinisë *Anopheles*.

Ndërkohë, në thelb, autorizimi konfirmon se lëndët vepruese në përbërje të produktit përfshihen në listat e lëndëve të miratuara dhe se produkti është i lejuar për vendosje në treg, por jo domosdoshmërisht që ai ka efektivitet të plotë dhe të provuar për çdo organizëm target specifik në çdo kontekst operacional.

Paraqitja e autorizimit si provë absolute e efektivitetit universal mund të krijojë perceptim të gabuar në treg, të deformojë konkurrencën e drejtë dhe, më e rëndësishmja, të ndikojë në përzgjedhjen e produkteve që mund të mos përmbushin në mënyrë optimale objektivin e mbrojtjes së shëndetit publik.

Në përfundim, me qëllim garantimin e zbatimit korrekt të kuadrit rregullator, mbrojtjen e konkurrencës së ndershme në treg dhe sigurimin e ndërhyrjeve efektive në funksion të shëndetit publik, Ju lutemi për një sqarim zyrtar lidhur me çështjet e ngritura më sipër.

Një përgjigje e qartë nga ana Juaj do të kontribuojë jo vetëm në orientimin e drejtë të operatorëve ekonomikë në përzgjedhjen e produkteve biocide, por edhe në forcimin e besimit në procesin e autorizimit dhe përdorimit të tyre.

Duke Ju falënderuar paraprakisht për bashkëpunimin institucional, mbetemi në pritje të përgjigjes Suaj,

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe informacionit dhe dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit “NRG” SHPK mbi modifikimin e dokumentave të tenderit për procedurën e prokurimit objekt ankimi konkretisht mbi kërkesën për paraqitjen e akt autorizimit për produktet biocide të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik në kriteret e vecanta të kualifikimit, KPP vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 6 “Formulari i specifikimeve teknike” autoriteti kontraktor ka përcaktuar si vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

(I njëjtë për të gjitha lotet)

I. Të dhëna të përgjithshme

Procesi i dezinfektimit të mushkonjave do të bazohet në një program parandalimi dhe kontrolli, i cili synon uljen e dendësisë së mushkonjave në zonat e përzgjedhura nëpërmjet kontrollit të larvave me larvicide dhe/ose barriera fizike, apo nëpërmjet eliminimit të vatrave të zhvillimit të mushkonjave në fazën ujore.

Avantazhet që paraqet kontrolli në fazën ujore:

- larvat kapen më lehtë pasi ato nuk mund të largohen nga vendi i zhvillimit /vatra me ujë;
- larvat brenda vatrës ose zonës me ujë qëndrojnë të izoluar aty për një kohë relativisht të gjatë (nga 7 deri në 14 ditë);
- mund të trajtohen në çdo kohë;
- në një zonë të vogël, të kufizuar mund të jenë të përqendruara një numër i madh larvash;
- efekti i larvicideve ka një kohëzgjatje të madhe krahasuar me adulticidet: larvave të sapoçelura nga vezët, u nevojiten zakonisht mesatarisht deri në dy javë që të realizojnë plotësisht ciklin e tyre të zhvillimit në ujë dhe të dalin në fluturim, periudhë në të cilën larvicidi vazhdon efektin e tij, ndërsa aplikimi i adulticidit mund të jetë i nevojshëm të përsëritet brenda 24 orëve, për shkak të emigrimit të mushkonjave në territorin përreth.

Sipërfaqet që do të trajtohen do të jenë me ujë dhe me larva të mushkonjave në habitate që përfshijnë laguna, parqe (vatra të përhershme dhe/ose të përkohshme), kanale, pellgje, puseta dhe bodrume, etj. Trajtimet do të kryhen bazuar në specifikimet teknike, gjetjet dhe konfirmimet e pranisë së larvave në terren me anë të monitorimit entomologjik, para çdo trajtimi.

Në zonat urbane shqetësim përbëjnë kryesisht mushkonjat e gjinisë *Aedes* dhe *Culex* të cilat njihen edhe për rolin e tyre vektorial në transmetimin e patogjenëve si virusin e Nilit Perëndimor (ËNV), virusin Chikungunja, Dengue, ZIKA etj. ndërsa në zonat bregdetare gjithashtu edhe ato të gjinisë *Anopheles* (vektor të malarisë), *Aedes* (*Ochlerotatus*) që shkaktojnë shumë bezdisje me pickimet e tyre sidomos në muzg, etj.

II. Llojet e ndërhyrjeve të rekomanduara për kontrollin e larvave të mushkonjave dhe specifikimet teknike sipas habitateve

- A.** Trajtime periodike me larvicide në Zona të Mbrojtura Natyrore (ZMN) vatra të përkohshme dhe të përhershme në laguna, parqe, kanale, pellgje etj, sipas zonave të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

Trajtimet kryhen, në periudhën Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhe kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh/vit, me kërkesë të AK.

Çdo cikël trajtimi në habitatet e mësipërme të përfundojë brenda 48 orëve nga data e fillimit, për të shmangur daljen në fluturim të adulteve të llojeve të mushkonjave që zhvillohen në këto habitate.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës do të përcaktohet nga AK për çdo trajtim.

Vendet potenciale të shumimit të larvave të mushkonjave ku nuk konfirmohet prania e larvave apo të cilat janë të thata nuk duhet të trajtohen.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Në vatrat e përhershme të zhvillimit të larvave, inspektimi para trajtimit duhet të bëhet çdo dy javë. Në vatrat e përkohshme të shumimit të larvave, inspektimi duhet të bëhet brenda 24-48 orëve pas reshjeve, baticës ose përmbytjeve natyrore/artifciale.

Për trajtimin e lagunave, parqeve, kanaleve, pellgjeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën web-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën web-GIS të të dhënave lidhur me pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit. Shërbimi kryhet gjatë orëve të ditës.

✓ **Produktet larvicide që duhet të përdoren**

Shërbimi i dezinfektimit në habitatet e mësipërme përfshin zonat bregdetare dhe urbane. Lagunat bregdetare të vendit tonë janë zona të mbrojtura natyrore nga konventa kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të gjithë kanalet që trajtohen në zonën bregdetare derdhen drejtpërdrejt ose indirekt në det.

Produktet larvicide që duhet të përdoren për trajtimin e habitateve të mësipërme nuk duhet të jenë toksike/të rrezikshme për organizmat ujorë dhe tokësorë jo target dhe nuk duhet të jenë të dëmshëm për njerëzit, kafshët, dhe mjedisin, dhe me efikasitet jo më pak se sa dy javë. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe në etiketë. Në zonat e mbrojtura natyrore, për të ruajtur mjedisin e ndjeshëm pranohet vetëm përdorimi i produkteve larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.)/ose **ekuivalent**, ose *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus* /ose **ekuivalent**, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të jetë me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën 2 javësh në habitatet specifike.

Në vatrat ujore që janë të mbuluara me shumë bimësi depërtimi i formulimeve lëng mund të pengohet nga bimësia. Në këto kushte, të përdoret formulim në gjendje të thatë (ose Granula), i cili depërton bimësinë duke arritur deri në vatrën ujore.

Në vatrat ku është e vështirë të kryhet trajtimi nga toka, mund të kryhen aplikime nga ajri.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid biocid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin, organizmat ujore e tokësorë jo target dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara, duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

B. Trajtime periodike me larvicide në puseta dhe bodrume me ujë.

Trajtimet kryhen në periudhën nga Prill/Maj deri në Shtator/Tetor të çdo viti kalendarik, pra për një periudhe kohe të pritshme mesatare prej 6 muajsh, me kërkesë të AK.

Data e saktë e fillimit dhe e përfundimit të punës përcaktohet nga AK.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë, kryhet një herë në muaj, sipas zonave të përcaktuara nga AK.

Organizimi i shërbimit dhe të gjitha procedurat e nevojshme për realizimin në kohë dhe me cilësi është përgjegjësi e OE.

Trajtimi i bodrumeve dhe pusetave me ujë të përfundojë brenda një periudhe 2-3 ditore nga momenti i fillimit të trajtimit (vetëm në rast se përcaktohet ndryshe nga AK).

- Gjatë trajtimit të pusetave OE duhet të mbajë aparatën GPRS vazhdimisht të ndezura dhe në gjendje funksionale gjatë kryerjes së shërbimit për transmetimin në platformën web-GIS të dhënave (apicall) që gjenerohen, lidhur me vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik latitude, longitude) gjatë realizimit të shërbimit.

OE është përgjegjës për menaxhimin e të dhënave të gjeoreferencuara dhe përshtatjen e tyre për ngarkimin në strukturën e të dhënave të standardizuara në platformën web-GIS.

- Për trajtimin e bodrumeve punonjësit e OE që kryejnë shërbimin duhet të jenë të paisur me aparat GPRS për të transmetuar në platformën web-GIS në kohë reale vend-ndodhjen (pozicionin gjeografik) e tyre, gjatë kryerjes së trajtimit. Është përgjegjësi e OE mbajtja e aparateve GPRS vazhdimisht në gjendje funksionale dhe të ndezura gjatë kryerjes së shërbimit dhe përshtatja për transmetimin në platformën web-GIS të të dhënave lidhur me

pozicionin gjeografik (latitude, longitude) dhe mbulimin e zonës në hartë gjatë kryerjes së trajtimit.

OE duhet të dorëzojë:

- një raport me informacionin sipas formatit të përcaktuar nga AK;
- hartën e zonave përkatëse (sipas hartës digjitale) para dhe pas trajtimit të printuar me ngjyra;
- gjurmët elektronike.

Efektet i pritshëm i shërbimit në bodrume dhe puseta me ujë duhet të jetë jo më pak se katër javë.

✓ **Produktet larvicide që duhet të përdoren**

Bazuar në sa më sipër për trajtimin e pusetave dhe bodrumeve rekomandohet të përdoren produkte larvicide me lëndë vepruese *Bacillus thuringensis israeliensis* (B.t.i.) i kombinuar me *Bacillus sphaericus*/ ose **ekuivalent** ose barriera fizike njështrësore/ose **ekuivalent** me efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje të aktivitetit prej të paktën katër javësh në habitatet specifike. Këto të dhëna tregohen në Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë së Produktit (ose MSDS), dhe/ ose në etiketë, dhe ose katalogun përkatës.

Është përgjegjësi e OE të ketë njohuri të plota për produktin larvicid, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet. OE duhet të kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar, si dhe duhet të kryejë kalibrimin e pajisjeve për të siguruar hedhjen e dozës së nevojshme për të arritur efikasitetin maksimal, por pa dëmtuar mjedisin dhe shëndetin e njerëzve. Ngordhja e larvave në vatrat e trajtuara duhet të jetë në masën 100%. Nëse gjatë procesit të monitorimit entomologjik pas trajtimit, do të gjenden larva të gjalla, OE duhet të ritrajtojë menjëherë vatrat ku gjenden larva të gjalla me shpenzimet e tij financiare, që nuk mbulohen nga AK.

Produktet Biocide autorizohen në vendin tonë sipas VKM nr 933 datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”.

Të tjera

OE është përgjegjës për sigurinë e punonjësve të tij dhe sigurimin e veshjeve personale mbrojtëse për realizimin e shërbimit.

OE është përgjegjës për çdo dëmtim të mjedisit dhe mban përgjegjësi sipas legjislacionit në fuqi. Punonjësit duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi dhe të përdorin veshje të dukshme me tregues të qartë të emrit dhe ose logos së kompanisë.

Është përgjegjësi e OE sigurimi dhe paraqitja e dokumentacionit që provon kapacitetet e tij teknike lidhur me pajisjet që do të përdorë për realizimin e trajtimeve, metodologjinë e trajtimit, produktin larvicid që do të përdor, duke i listuar dhe përshkruar specifikimet teknike të përdorimit të tyre sipas habitateve të pritshme për trajtim dhe produkteve larvicide/biocide me të cilat parashikon të kryej trajtimin.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” pika 2.3.2 “kapaciteti teknik” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.2 *Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.*

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”

III.1.5. Në nenin 8 të ligjit nr. 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide

1. Produktet biocide për kontrollin e organizmave të dëmshëm për shëndetin publik, që hyjnë, prodhohen dhe/ose përdoren në territorin e Republikës së Shqipërisë, vendosen në treg pas pajisjes me autorizim nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

2. Autorizimi për vendosjen në treg të produkteve biocide lëshohet për:

a) produkte biocide të prodhuara në vend, por të autorizuara paraprakisht në një nga vendet e Bashkimit Evropian;

b) produkte biocide të importuara dhe të autorizuara paraprakisht në njërin nga vendet e Bashkimit Evropian, pavarësisht vendit të origjinës.

3. Për pajisjen me autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, personi fizik ose juridik, në cilësinë e kërkuarit, duhet të ketë të punësuar një drejtues teknik të diplomuar në mjekësi, shëndet publik, kimi, biologji ose agronomi.

4. Kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe procedura e dhënies së autorizimit për vendosjen në treg të produkteve biocide përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

5. Miratimi i lëndëve vepruese, i përbërësve të tjerë në përmbajtje të produkteve biocide, si dhe përditësimi i tyre, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

6. Miratimi i të dhënave teknike të dosjes së regjistrimit të produkteve biocide, si dhe përditësimi i tyre, në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian, bëhet me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”

III.1.6. Në nenin 41 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në

çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.1.7. Në VKM nr. 933, datë 25.11.2020 “Për përcaktimin e rregullave për kriteret e vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg” Kreu III “Përmbajtja e dosjes së aplikimit për autorizim” përcaktohet se: “1. Dosja e aplikimit për autorizim për vendosjen në treg të produkteve biocide, së bashku me kërkesën për pajisjen me autorizim, përmban dokumentet e mëposhtme: a) Një dosje dhe letër aksesi për produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën III të këtij vendimi; b) Një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, përfshirë: - emrin tregtar të produktit biocid; - emrin dhe adresën e aplikantit; - përbërjen cilësore e sasiore të produktit lidhur me lëndët vepruese dhe lëndët e tjera jovepruese, si dhe njohuri të domosdoshme për përdorimin e duhur të produktit biocid; - prodhuesit e produktit biocid (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - prodhuesit e lëndëve vepruese (emri, adresa, vendndodhja e linjave të prodhimit); - tipi i formulimit të produktit biocid; - frazat e rrezikut dhe parandalimit; - tipi i produktit biocid dhe një përshkrim i saktë i përdorimit për të cilin kërkohet autorizimi; - organizmat target; - dozat e aplikimit dhe udhëzimet për përdorimin; 4 - kategoritë e përdoruesve; - të dhëna mbi ndikime të mundshme direkte apo indirekte të produktit biocid në mjedis dhe përcaktimin e masave përkatëse për minimizimin e këtyre ndikimeve në mjedis; - udhëzues për nxjerrjen e sigurt jashtë përdorimit të produktit dhe ambalazhit; - kushtet e ruajtjes dhe jetën e ruajtjes së produktit biocid për kushte normale të ruajtjes; - informacion tjetër relevant rreth produktit biocid. c) Një dosje dhe letër aksesi për çdo lëndë vepruese të miratuar, që përmbahet në produktin biocid, që plotëson kërkesat e përcaktuara në shtojcën II të këtij vendimi; ç) Letra e aksesit duhet të përmbajë së paku informacionin e mëposhtëm: - emrin dhe detajet e kontaktit të zotëruesit të të dhënave dhe personit të tretë; - emrin e substancës vepruese ose të produkteve biocide për të cilat është i autorizuar përdorimi i të dhënave; - datën në të cilën letra e aksesit hyn në fuqi; - një listë të të dhënave të paraqitura për të cilat letra e aksesit i jep të drejtën e citimit. d) Aplikanti nuk ka nevojë të paraqesë të dhëna për ekspozimin, nëse nuk parashikohet ekspozim që shoqëron përdorimet e propozuara dhe nuk është e nevojshme shkencërisht që të paraqiten të dhëna, apo nuk është teknikisht e mundur që të prodhohen të dhëna të tilla; dh) Të dhënat që provojnë se produkti biocid është i autorizuar në një nga vendet e përcaktuara në pikën 4, të nenit 8, të ligjit nr. 95/2015, dhe është i përfshirë në bazën e të dhënave të Agjencisë Evropiane të Kimikateve për produktet biocide të autorizuar. Aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që zotëron autorizimin e këtij produkti biocid, të përkthyer dhe të noterizuar në gjuhën shqipe; e) Për produktet biocide që janë subjekt i procedurës së thjeshtuar të autorizimit, sipas përcaktimeve në kreun IV, të shtojcës I, të këtij vendimi: - një përmbledhje të karakteristikave të produktit biocid, sipas referimit në pikën I(a) të këtij kreu; - të dhënat e efikasitetit; dhe - çdo informacion tjetër relevant në mbështetje të konkluzionit se produkti biocid plotëson kushtet e përcaktuara në kreun IV të këtij vendimi; - të dhënat që

provojnë se aplikantit i është lëshuar autorizimi i produktit biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian ose aplikanti ka marrë me shkrim aksesin e përdorimit të autorizimit nga subjekti që e ka marrë autorizimin e këtij produkti biocid në një nga vendet e Bashkimit Evropian; të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe. ë) Etiketën përkatëse të produktit biocid, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 487, datë 29.6.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin e produkteve biocide”; f) Dokumentacioni me të dhënat e sigurisë (MSDS) për produktet biocide në gjuhën shqipe dhe angleze, në formë të printuar dhe elektronike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kimikatet. g) Mostrën e produktit biocid me paketimin dhe etiketën në gjuhën shqipe, siç do të hidhet në treg; gj) Licencën e QKB-së për vendosjen në treg të produkteve biocide; h) Lejen mjedisore, me emërtimin përshkrues të veprimtarisë sipas shtojcës 1, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar; i) Faturën e pagesës së aplikimit”

III.1.8. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, autoriteti kontraktor ka argumentuar hartimin e këtij kriteri si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë AKT Autorizimin e produktit Biocid, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, për kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, e vlefshme në momentin e hapjes së ofertave.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4 germa a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjit 95/2015 “Për shërbimet dhe produktet biocide në shëndetin publik”, si dhe në zbatim të VKM-së nr.933, datë 25.11.2020 “Përcaktimin e rregullave të vlerësimit të produkteve biocide dhe të procedurës së dhënies së autorizimit të vendosjes së tyre në treg”, ky kriter siguron informacion të detajuar mbi përbërjen, përdorimin, masat mbrojtëse dhe veprimet në rast emergjence.*

Gjithashtu, kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 21 pika 4 dhe Nenin 22 pika 1 të ligjit nr. 9108, datë 17.7.2003 “Për substancat dhe preparatet kimike”, i ndryshuar.

III.1.9. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlerëson, se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkret e rëndësishme për autoritetin kontraktor, referuar natyrës së kontratës është realizimi i objektit të prokurimit në përputhje me specifikimet teknike natyrën dhe përmasat e kontratës në fjalë. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve

ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

III.1.10. Për sa i përket pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “NRG” SHPK mbi paraqitjen e akt-autorizimit të produktit biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, Komisioni çmon se ky është thelbi real i ankimit, por njëkohësisht edhe pjesa ku ankuesi ka deformuar më shumë përmbajtjen e DST-së. Ankuesi e ka ndërtuar argumentin e tij mbi tezën se autoriteti kontraktor po kërkon në fazën e ofertimit një “autorizim importi” ose një autorizim personal të operatorit ekonomik. Kjo premisë është e pasaktë. Nga leximi i drejtpërdrejtë i kriterit 2.3.2 rezulton se autoriteti kontraktor ka kërkuar “AKT Autorizimin e produktit biocid”, lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për produktet biocide që do të përdoren për kryerjen e shërbimit objekt prokurimi, të vlefshëm në momentin e hapjes së ofertave. Pra, dokumenti i kërkuar nuk është autorizim abstrakt për subjektin si importues, por provë që produkti konkret me të cilin do të kryhet shërbimi është produkt i autorizuar. Ankuesi, në vend që të godasë kriterin real, ka zgjedhur ta zhvendosë pretendimin drejt një kuptimi tjetër të dokumentit, dhe më pas ta kundërshtojë atë kuptim të shtrembëruar.

Një ankim i ndërtuar mbi një premisë faktike të pasaktë nuk mund të prodhojë përfundim të drejtë juridik. Pikërisht për këtë arsye, analiza e këtij kriteri duhet bërë *in concreto* dhe *jo in abstracto*. Shërbimi objekt prokurimi nuk është një shërbim i përgjithshëm dezinfektimi ku mjete teknik mund të zëvendësohet pa pasoja materiale gjatë ekzekutimit, por një shërbim i specializuar dezinfektimi që kryhet në habitate ujore të hapura, në laguna, kanale dhe zona të mbrojtura natyrore, si dhe në puseta e bodrume me ujë në mjedise urbane të mbyllura.

Për tu kthyer te pretendimet mbi kriterin e përcaktuar në pikën 2.3.2 të kritereve të vecanta të kualifikimit mbi paraqitjen e akt-autorizimit të produktit biocid lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të gjitha produktet biocide, Komisioni vëren se vetë DST parashikon se produktet që do të përdoren nuk duhet të jenë toksike për organizmat ujorë dhe tokësorë jo-target, nuk duhet të jenë të dëmshme për njerëzit, kafshët dhe mjedisin, duhet të kenë efikasitet të provuar dhe kohëzgjatje minimale veprimi, jo më pak se dy javë në habitatet e hapura dhe jo më pak se katër javë për puseta e bodrume. Për zonat e mbrojtura natyrore, DST kufizon përdorimin në produkte me lëndë vepruese *Bacillus thuringiensis israelensis (B.t.i.) ose ekuivalent*, apo *B.t.i. të kombinuar me Bacillus sphaericus ose ekuivalent*, me kusht që ekuivalenti të mos dëmtojë dhe të mos jetë toksik për gjallesat e tjera dhe të ketë efikasitet të provuar. Këtu bëhet e qartë se produkti biocid nuk është element anësor i kontratës, por *kusht sine qua non* e realizimit të saj.

Në këto kushte, akt-autorizimi i produktit biocid nuk ka funksion formal, por funksion material. Ai nuk kërkohet thjesht për të treguar se operatori ekonomik ka plotësuar një hallkë administrative, por për të vërtetuar se oferta e tij mbështetet mbi një mjet teknik konkret, të ligjshëm dhe të vlerësuar paraprakisht nga autoriteti kompetent për sa i takon përbërjes, përdorimit, efikasitetit dhe riskut.

Kjo del edhe nga mënyra sesi DST ka ndërtuar provueshmërinë përmes dokumentave: kriteri 2.3.2 kërkon akt-autorizimin e produktit biocid, ndërsa kriteri 2.3.3 kërkon etiketat, katalogët, skedat teknike dhe Dokumentin e të Dhënave të Sigurisë (MSDS). Këto dokumente nuk janë alternative njëra me tjetrën dhe as nuk mbivendosen pa kuptim. Autorizimi provon ligjshmërinë rregullatore të produktit; etiketa, katalogu, skeda teknike dhe MSDS provojnë parametrat teknikë, mënyrën e përdorimit, riskun, dozimin dhe karakteristikat e sigurisë. Prandaj, pretendimi i ankuesit se mjaftojnë dokumente të tjera teknike ose tregtare bie, sepse ai ngatërron funksione dokumentare të ndryshme. Dokumenti tregtar nuk zëvendëson autorizimin rregullator; dokumenti teknik nuk zëvendëson aktin administrativ që lejon vendosjen në treg dhe përdorimin e produktit.

Ankuesi pretendon se procedura e autorizimit të produkteve biocide është e gjatë dhe, për këtë arsye, kërkesa e DST-së që detyron operatorët ekonomikë që të paraqesin autorizimin për të gjitha produktet biocide që në momentin e hapjes së ofertave është disproporcionale. Ky argument nuk qëndron. Legjislacioni sektorial për biocidet është ndërtuar pikërisht mbi logjikën e kontrollit paraprak dhe jo të legalizimit të mëvonshëm. Fakti që autorizimi kërkon kohë nuk është argument kundër kriterit, por dëshmi se ligjvënësi dhe autoriteti sektorial e kanë konsideruar produktin biocid një produkt të ndjeshëm për shëndetin publik dhe mjedisin. Autoriteti kontraktor nuk është i detyruar të ulë nivelin e kontrollit vetëm sepse operatori ekonomik nuk është i gatshëm në treg me produkt të autorizuar në momentin kur konkurron për kontratën. Në të kundërt, në një sektor të rregulluar fort, operatori që hyn në garë duhet të jetë *ex ante* në gjendje të provojë se mjeti themelor teknik me të cilin do ta realizojë kontratën është i ligjshëm. Prokurimi publik nuk ekziston për t'u dhënë operatorëve kohë të rregullojnë më vonë kushtet bazë të ligjshmërisë së ofertës së tyre. Pretendimi i ankuesit se autorizimi duhet të kërkohet vetëm para nënshkrimit të kontratës ose para fillimit të zbatimit të saj nuk qëndron, sepse ai e trajton produktin biocid si një element të vonshëm të ekzekutimit, ndërkohë që në këtë procedurë ai është pjesë integrale e ofertës qysh në çastin e konkurrimit.

Po ashtu, Komisioni vlerëson se nuk qëndron as argumenti sipas të cilit autorizimi është atribut i produktit biocid dhe jo i subjektit, prandaj kriteri qenka i paligjshëm. Pikërisht sepse autorizimi është atribut i produktit, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kërkojë që operatori ekonomik të provojë se produkti konkret me të cilin do të kryejë shërbimin është produkt i autorizuar. Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se operatori duhet të jetë vetë importuesi ose mbajtësi formal i autorizimit në kuptimin tregtar, por do të thotë se ai duhet të paraqesë ofertë të mbështetur mbi

një produkt të identifikuar, të autorizuar dhe realisht të disponueshëm për ekzekutimin e kontratës. Në këtë kuptim, autoriteti kontraktor nuk ka personalizuar në mënyrë të paligjshme autorizimin, por e ka përdorur atë si mjet provues për ligjshmërinë dhe seriozitetin e ofertës. Teza e ankuesit dështon sepse ngatërron dy pyetje të ndryshme: pyetjen se kujt i lëshohet akti i autorizimit sipas legjislacionit sektorial dhe pyetjen se çfarë provash ka të drejtë të kërkojë autoriteti kontraktor për të verifikuar se operatori ka në dispozicion një produkt të ligjshëm për të ekzekutuar kontratën. Këto nuk janë e njëjta gjë.

Nga ana tjetër, vetë DST përmban një element tjetër që e rrëzon ankimin në mënyrë të plotë: ajo përcakton se operatori ekonomik duhet ta kryejë trajtimin me produktet larvicide që ka ofertuar dhe duhet të ketë njohuri të plota për produktin, dozat e përdorimit, efektet në mjedis dhe shëndet, si dhe detyrimin për të kalibruar pajisjet në mënyrë që të arrihet efikasitet maksimal pa dëmtuar mjedisin, organizmat ujore e tokësorë jo-target dhe shëndetin e njerëzve. Po ashtu, DST kërkon rezultat konkret, në masën 100% të ngordhjes së larvave, dhe parashikon ritrajtim të menjëhershëm me shpenzimet e operatorit nëse gjenden larva të gjalla.

Kjo do të thotë se produkti i ofertuar nuk është element neutral, por mjete bazë nga i cili varet performanca e kontratës, efekti biologjik i shërbimit, profili i riskut mjedisor dhe vetë përgjegjësia kontraktore e operatorit. Sa më kritik të jetë ky element, aq më i fortë bëhet justifikimi për kontroll *ex ante* dhe aq më i dobët bëhet pretendimi se verifikimi mund të shtyhet pa problem në fazën e ekzekutimit.

Autoriteti kontraktor nuk mund të sillet sikur produkti biocid të ishte një mall i zakonshëm, përdorimi i të cilit të varet nga deklarimi i operatorit. VKM nr. 933/2020 pikërisht për këtë arsye vendos një regjim autorizimi, sepse produkti biocid duhet të vlerësohet në raport me formulimin, lëndën vepruese, organizmat target, dozat e aplikimit, kategoritë e përdoruesve, ndikimet në mjedis, masat e minimizimit të riskut, kushtet e ruajtjes dhe dokumentacionin e sigurisë. Vetë dokumenti i shqyrtuar citon se dosja e autorizimit përmban pikërisht këto elemente thelbësore të produktit. Për rrjedhojë, akt-autorizimi nuk është një dokument neutral apo formal, por një provë normative dhe teknike njëkohësisht. Ai individualizon produktin konkret që operatori ka në dispozicion, verifikon që produkti është i lejuar për përdorim në Republikën e Shqipërisë, përcakton kushtet dhe kufizimet e përdorimit, frazat e rrezikut dhe parandalimit, organizmat target, tipin e formulimit, dozat dhe kategoritë e përdoruesve, si dhe vërteton se produkti është kaluar në një filtër institucional të posaçëm të shëndetit publik dhe mbrojtjes së mjedisit.

Nëse do të pranohej teza e ankuesit dhe autorizimi do të kërkohej vetëm para nënshkrimit të kontratës ose para fillimit të zbatimit, autoriteti kontraktor do të detyrohej të krahasonte oferta të ndërtuara mbi produkte ende hipotetike, eventuale ose të painedividualizuara përfundimisht. Një ofertë e tillë nuk është ofertë plotësisht e krahasueshme me ofertën e një operatori që ka identifikuar qysh në momentin e konkurrimit produktin konkret, të autorizuar, me efikasitet dhe profil risku të provuar. Kjo do të cenonte parimin e transparencës, sepse objekti real teknik i

ofertës do të mbetet i lëvizshëm; do të cenonte parimin e trajtimit të barabartë, sepse operatori i përgatitur do të trajtohej njësoj me operatorin që ende nuk e ka siguruar bazën ligjore dhe materiale të ofertës; dhe do të cenonte edhe vetë seriozitetin e procedurës, sepse vlerësimi do të bëhej mbi premtime dhe jo mbi oferta të zbatueshme. Pikërisht për të shmangur këtë pasiguri, legjislacioni sektorial i biocideve dhe logjika e prokurimit publik takohen në një pikë të përbashkët: kontrolli mbi ligjshmërinë e produktit duhet të jetë paraprak dhe jo i shtyrë artificialisht në një moment të mëvonshëm, kur konkurrimi tashmë ka përfunduar. Ky standard është në përputhje edhe me logjikën e Rregullores (BE) nr. 528/2012, e cila e kushtëzon vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve biocide me autorizim paraprak.

Ankuesi ka kundërshtuar edhe ndalimin e mbështetjes në kapacitetet e subjekteve të tjera për pikën 2.3.2. Edhe ky pretendim nuk gjen mbështetje. Vetë pika 2.16 e DST-së e shpjegon qartë arsyen e këtij ndalimi: kërkesa lidhet ngushtë me aftësinë e ofertuesit për zbatimin e kontratës, përdorimi i produkteve biocide përbën element thelbësor të kontratës dhe përfshin përgjegjësi të drejtpërdrejtë ligjore e mjedisore; mbështetja tek një subjekt i tretë do të cenonte garancinë për kontroll real, disponueshmëri të vazhdueshme të produktit dhe përgjegjësi të qartë në ekzekutimin e kontratës. Komisioni çmon se ky arsyetim është jo vetëm formal, por materialisht i drejtë. Në këtë rast, nuk kemi të bëjmë me një kapacitet të jashtëm periferik, siç mund të jetë një mjet ndihmës ose një referencë financiare, por me vetë bazën ligjore dhe materiale të mjetit teknik me të cilin do të kryhet shërbimi. Autoriteti kontraktor ka qenë në të drejtën e tij të konsiderojë se ky është një aspekt kritik i kontratës që nuk mund të lihet në varësi të një subjekti të tretë, për aq kohë sa shërbimi kërkon furnizim të pandërprerë, identifikim të saktë të produktit, kalibrim të dozës, kontroll të përdorimit, përgjegjësi për efektin biologjik dhe mbajtje të plotë të riskut mjedisor e shëndetësor.

Po aq i pabazuar është edhe pretendimi për diskriminim. Kriteri 2.3.2 nuk kërkon markë të caktuar, prodhues të caktuar, origjinë të caktuar apo kanal të mbyllur furnizimi. Përkundrazi, vetë specifikimet teknike pranojnë ekuivalentët, me kusht që të provohet se ata nuk janë toksikë për gjallesat e tjera dhe se kanë efikasitetin e kërkuar. Kjo do të thotë se autoriteti kontraktor nuk ka mbyllur tregun për një operator të caktuar, por ka vendosur një filtër funksional dhe të justifikuar: cilido operator mund të konkurrojë, me kusht që produkti me të cilin do të realizojë shërbimin të jetë produkt i autorizuar, i sigurt dhe teknikisht i përshtatshëm. Kjo është thelbi i proporcionalitetit.

Një kriter nuk bëhet automatikisht diskriminues vetëm sepse kërkon gatishmëri reale dhe pajtueshmëri ligjore; përndryshe, çdo kriter serioz do të konsiderohej kufizues vetëm sepse përjashton operatorët e papërgatitur. Proporcionaliteti nuk matet duke parë nëse kriteri “përjashton” dikë, por duke parë nëse ai është i përshtatshëm, i nevojshëm dhe jo i tepruar në raport me objektivin legjitim që ndjek. Këtu, objektivi legjitim është mbrojtja e shëndetit publik, mjedisit, organizmave jo-target dhe realizimi korrekt i kontratës në habitate të ndjeshme natyrore

e urbane. Kriteri i vendosur është i lidhur drejtpërdrejt me këtë objektiv dhe nuk rezulton të ketë ndonjë alternativë tjetër më të butë që të japë të njëjtin nivel sigurie juridike dhe teknike.

Për këto arsye, Komisioni arrin në përfundimin se kriteri 2.3.2 është i lidhur ngushtë me objektin e kontratës, është teknikisht i arsyetuar, nuk është formalitet i panevojshëm, nuk personalizon në mënyrë të paligjshme autorizimin, nuk krijon diskriminim artificial dhe nuk shkon përtej asaj që është e nevojshme për verifikimin e seriozitetit, ligjshmërisë dhe realizueshmërisë së ofertës. Përkundrazi, ky kriter është instrument thelbësor i kontrollit *ex ante* mbi mjetin kryesor teknik të shërbimit. Teza e ankuesit që autorizimi i produktit mund të shtyhet krejtësisht në fazën e ekzekutimit bie në kundërshtim me vetë natyrën e shërbimit, me strukturën e DST-së, me logjikën e kontrollit paraprak të biocideve dhe me parimet themelore të krahasueshmërisë reale të ofertave.

Sa më lart pretendimet e ankimuesit “NRG” SHPK nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendim i Këshillit të Ministrave nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik” Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NRG” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76063-02-12-2026, me objekt: Loti 3: “Shërbim dezinfektimi në zonat bregdetare dhe urbane, Qarku Durrës” me fond limit 11,251,992.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për t’u zhvilluar në datë 17.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
2. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “NRG” SHPK.

4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

